

THESARE

MJET FRYMËZIMI DHE UDHËRRËFYES PËR PASTORËT DHE SHËRBYESIT

numri 6 / vjeshtë 2015

Editorial 2
Gëzim Spahija

Çfarë Ka Jezusi Kaq të Veçantë? 3
Ivan Satyavrata

Ungjilli Sipas Gjonit 3:16 9
Craig Keener

A Është Perëndia Thjesht një
Patericë Psikologjike për të Dobët? 14
Paul Copan

Përshtypje nga
Konferenca Ballkanike
e Të Rinjve 19
Gëzim Spahija

A Është Jezus Krishti Biri i Perëndisë? 22
Joseph Cumming

Progresi Drejt Pjekurisë Frymërore 29
H. Maurice Lednický

Përvijim Predikimi 35
Jim Dearman



Tema e këtij numri: Sfidat për Ungjillin në Shekullin 21



Sfidat për Ungjillin

në shekullin 21

Zakonisht kur ne duam që të shmangemi ose të justifikohemi për një problem, themi që kohët kanë ndryshuar ose se sot gjërat janë ndryshe. Dhe kjo hipotezë është më se e vërtetë edhe në fushën e ungjillizimit. Është si një sindromë të cilën Jona e tregoi në kohën e vet, që vjen për shkak të mosvlerësimit të vlerave të krishtera, si dhe të ndryshimeve të mëdha që po ndodhin në kohët e fundit.

Sigurisht kohët kanë ndryshuar pas dy mijë vjetësh, dhe është normale që çdo brez do të përgjigjet për atë që ka bërë ose jo në kohën e vet, sikurse edhe ne sot jemi përballë kësaj përgjegjësie. Materializmi, skepticizmi i theksuar i njerëzve, pluralizmi dhe islamizmi ekstrem besoj se janë sfidat më të mëdha të kohës së sotme në ndarjen e ungjillit. Por ajo që na jep siguri është se ungjilli ka qenë dhe mbetet i njëjtë, i vërtetë, dhe i fuqishëm, transformues për të gjitha kohërat.

Dëshmia e ekzistencës së kishës në rritje kudo në botë na e pohon këtë gjë. Ungjilli është superior mbi çdo kohë dhe mbi çdo kulturë. Ungjilli është lajmi i mirë për shpëtimin e cilitdo që beson, në rrugën e përgatitur nga Perëndia. Por siç edhe vëllai ynë, Pali, na paralajmëron tek Letra e Dytë Drejtuar Timoteut, në ditët e fundit do të vijnë kohë të vështira, sepse njerëzit do të jenë egoistë, lakmues parash,

mburraveçë, mendjemëdhenj, blasfemues, të pabindur ndaj prindërve, mosmirënjohës, të pashenjtë.

Por nga Bibla ne marrim mandatin që vetë Jezusi na jep duke na nisur: *“Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt...”* Në të, ne marrim premtimin e fuqisë: *“Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të bëheni dëshmitarët e mi”*. Në të, ne marrim premtimin e sigurisë: *“Unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës”*. Na duhet që, përmes një jete të përgjegjshme në lutje, ne ta dëgjojmë thirrjen e Tij. Le ta mbajmë mesazhin, dhe le të ndjekim udhëzimet duke besuar në fuqinë e Tij, dhe pastaj le të ngremë zërin dhe le të shpallim mesazhin e Tij.

Nuk ka sfida që ta ndalë përhapjen e ungjillit të Jezu Krishtit. Nuk ka sfida që ta ndalë mesazhin e shpëtimit të botës. Plani i Perëndisë për shpëtimin e botës është i shkruar: *“Lum ai që ecën e lundron në të, duke u bërë pjesë e këtij plani”*.



GËZIM SPAHIJA

Drejtor Ekzekutiv i Këshillit të
Përgjithshëm të Asambleve të
Perëndisë të Shqipërisë

THESARE

Numri 6
Vjeshtë 2015

Koordinatorë e projektit: Stephanie Plagenhoef
Përkthyes: Fabian Tozharaku
Redaktues: Skënder Hoxha
Grafika kompjuterike: Lindita Sqapi

Botuar nga:
Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë
të Shqipërisë

Në bashkëpunim me:
Life Publishers International

Adresa: K.P. 119 / Kutia 2 / Tirana, Albania
Cel: 0694068956
Email: KTU@icc-al.org



Artikujt e zgjedhur dhe grafika përshtatur nga revista Enrichment - ©Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë, ShBA. Përdorur me leje.

©Life Publishers International. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

ÇFARE KA JEZUSI KAQ TË VEÇANTË?

Coe☆ist

NJË RRUGË
JEZUS

Përgjigje Ndaj Sfidës së Pluralizmit Fetar

Nga: **IVAN SATYAVRATA**

K

onflikti fetar karakterizon botën e pas 11 shtatorit 2001.

Megjithatë, shumë vetë sot nuk shohin terrorizmin në vetvete apo dhunën fetare si armikun e vërtetë të paqes dhe harmonisë globale, por fundamentalizmin ose totalitarizmin fetar.

Në mesin e
një shoqërie
që sa vjen e
bëhet më
e larmishme
nga ana
kulturore
dhe fetare,
cili duhet të
jetë pozicioni
i krishterë rreth
besimeve
të ndryshme
të fqinjëve tanë?

Në një artikull me titull “The Real War” (Lufta e Vërtetë)¹ që u publikua menjëherë mbas 11 shtatorit, Tomas Fridmën (Thomas Friedman), një analist i gazetës Nju Jork Tajms (*New York Times*), e shprehu këtë pikëpamje në mënyrë të sqartë, duke e hedhur fajin drejtpërdrejtë, për ato që ndodhën në 11 shtator, në prehrin e asaj të cilën ai e përkufizon si ideologjinë e totalitarizmit fetar – “një pikëpamje e botës, ku besimi im duhet të sundojë më lart dhe mund të konfirmohet dhe të besohet me pasion vetëm nëse gjithë të tjerët mohohen”. Ai i vendoste të gjitha fetë që kanë ardhur nga tradita biblike – judaizmin, krishterimin dhe islamizmin – brenda kësaj kategorie për shkak të tendencës së tyre për të besuar se ato kanë të vërtetën ekskluzive.

Fridmën është një përkrahës i fortë i një ideologjie pluralizmi që përqafon larminë fetare dhe lejon njohje të barabartë të komuniteteve alternative të besimit, në mënyrë që njerëzit të mund ta ushqejnë besimin e tyre pa pretenduar një të vërtetë ekskluzive. Duke cituar Rabinin Dejvid Hartmën (David Hartman) për të mbështetur

pikëpamjen e tij, Fridmën pyet: “A mund ta dinë islamizmi, krishterimi dhe judaizmi që Perëndia flet arabisht të premtëve, hebraisht të shtunave, dhe latinisht të dielave, dhe që Ai mirëpret qenie të ndryshme njerëzore që i afrohen Atij përmes historisë së tyre, me anë të gjuhës dhe trashëgimisë kulturore të tyre?”.



Pluralizmi
beson se
asnjë fe
nuk mund
të pretendojë
të jetë disi
normative
dhe superiore
ndaj të tjerave.

“A është i nevojshëm fanatizmi i devotshëm për të pasur pasion dhe mbijetesë fetare, apo mund të kemi një pikëpamje shumëgjuhëshe të Perëndisë – një nocion që Perëndia nuk përdoret plotësisht nga vetëm një shteg fetar?”. Kjo është një strategji klasike pluraliste e përfshirjes së feve, të cilat pretendojnë të vërtetën absolute, nën një shprehje klishe si “fanatizëm i devotshëm”, dhe duke e nënçmuar ndryshimin midis feve si një ndryshim në thelb gjuhësor, duke reflektuar përgjigje të kushtëzuara historikisht dhe kulturalisht ndaj realitetit përfundimtar. Çështja është e tillë që ka implikime të rënda, duke ngritur një sërë pyetjesh të vështira, disa prej të cilave godasin pikërisht aty ku besimit të krishterë i dhemb më shumë.

Në mesin e një shoqërie që sa vjen e bëhet më e larmishme nga ana kulturore dhe fetare, cili duhet të jetë pozicioni i krishterë rreth besimeve të ndryshme të fqinjëve tanë? A t'i shohim si territor i pushtuar nga armiku të cilin duhet ta zaptojmë për Krishtin, apo si pelegrinë që udhëtojnë nëpër shtigje të ndryshme, të cilat eventualisht të çojnë në të njëjtin destinacion? Kur e rrëfejmë Jezusin si Zot dhe Shpëtimtar universal, a do të thotë kjo se krishtërimi është feja e vetme e vërtetë dhe që në asnjë nga fetë e tjera as nuk bëhet fjalë të gjesh të vërtetë dhe mirësi? Nëse çdo fe pretendon të jetë ajo e vërteta dhe shih si misionin e saj konvertimin e atyre që janë në fetë e tjera, a nuk do e rrisë kjo paragjykimin fetar, fanatizmin fetar dhe grindjen e komuniteteve të ndryshme?

JOSHJA E PLURALIZMIT

Pluraliteti ose shumësia e feve dhe kulturave ka qenë një tipar integral i jetës brenda komunitetit njerëzor që prej kohëve të stërlashta. Megjithatë forcat binjake të modernizimit dhe globalizimit kanë dhënë ndihmesë për të ngritur një fenomen që është veçanërisht modern, edhe për sa i përket shumëllojshmërisë së kulturave që përjetohet nga shoqëritë e sotme, edhe për sa i përket përgjigjes bashkëkohore ndaj këtij realiteti brenda mjedisit kulturor global. Ndërkohë që fjala *pluralitet* ose *shumësi* i referohet thjesht faktit të shumëllojshmërisë kulturore dhe fetare, *pluralizmi* përshkruan më me saktësi një perspektivë egalitare e cila

ruan një barazi të ashpër në mesin e feve për sa i përket të vërtetës fetare.

Pluralizmi beson se asnjë fe nuk mund të pretendojë të jetë disi normative dhe superiore ndaj të tjerave – të gjitha fetë janë reagime të ndërlikuara njerëzore, të kushtëzuara historikisht dhe kulturalisht, ndaj realitetit të vetëm hyjnor. Ne duhet ta kremtojmë larminë e përvojave dhe shprehjeve fetare si diçka të mirë dhe të shëndetshme, dhe, për çdo fe, duhet ta pranojmë shpëtimin [ose ndriçimin ose çlirimin] si të pranishme dhe efikase, në mënyrën e tyre.

Një sërë faktorësh historikë dhe sociologjikë kanë çuar në tërheqjen në rritje që pluralizmi fiton tek njerëzit në botën tonë sot. Për një pjesë të mirë të historisë së botës, shumica e njerëzve jetonin në izolim nga etnitë dhe kulturat e tjera. Megjithatë, ardhja e globalizimit ka rezultuar në afërsi të paprecedentë me njëritjetrin, me njerëz të feve e të kulturave të ndryshme. Udhëtimet dhe teknologjia kanë sjellë në jetë një përzierje të njerëzve dhe kulturave që prindërit tanë as që mund ta imagjinonin.

Lidhja e ndërvarur që ekziston sot midis qosheve të ndryshme të globit e ka ndryshuar botën tonë në mënyrë të pakthyesme sa që planeti ynë është kthyer në një rrjet ndikimesh që kryqëzohen me njëra-tjetrën. Në këtë mënyrë, kultura “tjetër” është bërë më pak e huaj dhe e panjohur, duke rezultuar në një pranim të shtuar të ndryshimit. Një nënprodukt i rëndësishëm i kësaj ndër-përzierjeje kulturash është idealizimi i larmisë etnike dhe fetare dhe skepticizmi kundrejt pretendimeve të të vërtetës absolute tek feja.

Takimi modern midis kulturave mund të jetë një përvojë ekzotike dhe gazmore, por gjithashtu është e mbushur me tension dhe potencial për dhunë. Feja, e cila është në qendër të shumicës së kulturave, ka qenë burimi më i fuqishëm i konfliktit social këto kohë e fundit.

Ngritja e fundamentalizmit fetar është kështu një tjetër faktor që i është shtuar joshjes së pluralizmit në kohët tona, duke qenë se një pjesë argumentojnë se ideologjia fundamentaliste në çdo fe duket sikur prodhon urrejtje, dyshim dhe frikë tek ndjekësit e saj kundrejt feve të tjera. Vepra të kohëve të fundit që dokumen-

tojnë rritjen e terrorizmit fetar i vënë gishtin lidhjes së ngushtë që shpesh e vërejmë mes fundamentalizmit fetar dhe dhunës nga terroristët.² Në këtë kontekst, pluralizmi shfaqet sikur ofron një bazë ideologjike tërheqëse për qetësinë sociale.

SFIDA E PLURALIZMIT

Ideologjia e pluralizmit në dekadat e fundit ka qenë duke fituar besueshmëri dhe duke përhapur ndikimin e saj në mënyrë të qëndrueshme. Ajo formon sot një ortodoksi (pranimi i përgjithshëm) jozyrtare në një pjesë të madhe të fushës akademike, është tejet e përhapur në kulturën popullore bashkëkohore dhe është e ngulitur fort brenda elitës së medias dhe spektaklit. Megjithatë, një çështje me një shqetësim serioz është pranimi i saj në rritje në mesin e atyre që rrëfehen si të krishterë. Për shembull, merrni në konsideratë dy pjesë deklarata-tash nga të krishterë, të bazuara nga intervista të bëra nga sociologu Kristian Smith në një studim të krishterimit amerikan:

“Unë nuk besoj tek dërgimi i misionarëve. Nëse duam të shkojmë në Afrikë dhe të sigurojmë ndihmë mjekësore dhe t’u mësojmë njerëzve se si të punojnë tokën, atëherë jam dakord. Por nëse shkojmë në Japoni dhe përpigemi të konvertojmë besimtarët Shinto, atëherë s’jam fare dakord. Nëse ata do të vinin këtu dhe do të përpiqeshin të më konvertonin mua, do të nevikosesha shumë, dhe mendoj se ata kanë çdo të drejtë të ndihen po njësoj. Krishtërimi është fantastik. Unë, nga të gjitha fetë që ekzistojnë, jam i krishterë. Por mendoj se të tjerët kanë të drejtën të besojnë atë që duan vetë; dhe nëse shkojnë në ferr, atëherë thjesht morën kthesën e gabuar.”

“Të thuash që fetë e tjera e kanë gabim, do të thotë të jesh egocentrik. Unë madje as nuk ndihem rehat kur thonë se të gjitha fetë të drejtojnë tek i njëjti Perëndi. Çfarëdo që të bën të lumtur, për mua është në rregull, nëse ky është sistemi yt i besimit. Ne jemi të vdekshëm. Askush s’mund të na thotë kush e ka mirë e kush e ka gabim. Nëse kjo të ndihmon të ecësh në jetë dhe të ndihmon t’i japësh jetës tënde kuptim, atëherë shumë në rregull për mua.”³

Këto nuk janë opinionet e ateistëve apo

të relativistëve radikalë, por të të krishterëve të vetëshpallur të cilët e kanë pranuar ideologjinë pluraliste dhe e shohin Krishtin si një nga shumë shtigjet alternative për tek Perëndia.

Pluralizmi ngre pyetje vendimtare në lidhje me natyrën dhe qëllimin e misionit të krishterë dhe të vetë krishterimit. Ungjilli i krishterë i përmbahet besimit se të gjithë njerëzit janë mëkatarë dhe kanë nevojë për shpëtim, dhe Perëndia dëshiron shpëtimin e njerëzve nga çdo racë, kulturë dhe fe. Gjithashtu ky ungjill pohon se shpëtimi i Perëndisë vjen tek ne përmes një personi të veçantë: Jezus Krishtit, i cili është vetëzbulimi bindës i Perëndisë që mori mbi vete mëkatet e botës. Dhe, vetëm përmes besimit tek Ai qeniet njerëzore mund të ripërtërihen në marrëdhënie të drejtë me Perëndinë. Pluralizmi e kundërshton këtë kuptim të ungjillit si të pambrojtshëm nga ana intelektuale dhe të neveritshëm nga ana morale. Ai e godet qendrën e besimit të krishterë në tri pika kritike.

Së pari, pluralizmi sfidon pretendimin e krishterimit historik se ai ka të drejtë të privileguara ndaj zbulesës hyjnore në autoritetin unik që iu është akorduar 66 librave të kanunit protestant. Pluralistët pohojnë se toleranca kundrejt feve të tjera kërkon nga të krishterët që të pranojnë shkrimet e popujve me besime të tjera si shkrime të cilat kanë të njëjtin autoritet si Bibla. Krishterimi biblik, në anën tjetër, shpall se, megjithëse doktrina e zbulesës së përgjithshme ofron një bazë për ta njohur praninë e të vërtetës tek fetë e tjera (Romakëve 1:18 e në vazhdim; 2:12-16; Veprat 14:15 e në vazhdim), kjo nuk ka të njëjtin autoritet apo vlerë shpëtuese siç ka zbulesa në Jezus Krishtin.

Së dyti, pluralizmi duket se i ka vënë sëpatën pretendimit qendror themelor të besimit të krishterë – që Jezusi i Nazaretit nuk ishte thjesht një si shumë të tjerë, dhe as figura më e madhe e të gjitha figurave fetare të njerëzimit, por Ai është vetë-zbulimi bindës i vetë Perëndisë së përjetshëm. Pluralistët e konsiderojnë këtë pretendim si arrogant, një pengesë e pamundur në lëvizjen drejt harmonisë ndërfaqetare që është kaq thelbësore për paqen në botë. Megjithëse të krishterët mund të besojnë se Jezusi është unik dhe normativ për ta, ata nuk

Pluralistët

kërkojnë

të formojnë

një krishtologji

revizioniste

radikale

e cila e zbraz

Jezusin

në mënyrë efikase

nga çdo

pretendim

bindës.



mund të pretendojnë se Jezusi është unik dhe normativ në një kuptim universal. Jezusi mund të jetë Shpëtimtari për të krishterët, por Ai nuk është shpëtimtari i vetëm për të gjithë popujt. Dhe kështu pluralistët kërkojnë të formojnë një krishtologji revizioniste radikale e cila e zbraz Jezusin në mënyrë efikase nga çdo pretendim bindës.

Një problem i tretë serioz me pluralizmin është besimi i tij se fetë e ndryshme përfaqësojnë shumë shtigje të ndryshme që të çojnë tek i njëjti qëllim përfundimtar. Dhe kështu traditat e ndryshme fetare thjesht përshkruajnë reagimet nga kontekste të ndryshme brenda të cilave burra dhe gra, në thelb, përjetojnë të njëjtin shpëtim apo ndriçim. Pluralistët supozojnë se njerëzit e singertë dhe të respektuar nga ana morale thjesht nuk mund të gabojnë rreth besimeve fetare bazë, veçanërisht kur këto besime dhe praktika duket se kanë ndikime përfituese. Në mënyrë të kuptueshme, kjo perspektivë ka njëfarë tërheqjeje emocionale, por qartësisht dobëson shkakun dhe motivimin për misionin e krishterë.

PLURALIZMI I DEMASKUAR

Pluralizmi e manifeston veten në një gamë të gjerë shprehjesh, që nga një intuitë paksa të papërpunuar e të pazhvilluar se Perëndia do të pranojë njerëzit e singertë e të mirë nga çdo besim ose edhe pa besim, e deri tek modelet e sofistikuar filozofike. Por a ka argumente të forta pozicioni pluralist? Shumë rrallë, për të mos thënë asnjëherë, hasim përpjekje serioze për një mbrojtje nga ana biblike të pluralizmit. Pluralizmi gjithashtu, si një trend relativisht modern, ka shumë pak ose aspak mbështetje në traditën e kishës. Si rrjedhojë, kriteret teologjike që angazhohen në interpretimet pluraliste priren të jenë arbitrare (të paarsyeshme). Megjithatë, pluralizmi, përmes vetë metodave të tij, mund të peshohet dhe të gjendet i mangët. Do të shohim që pluralizmi nuk arrin që të qëndrojë i bashkuar as në aspektin empirik (vëzhgues), as në atë logjik, ndërkohë që e hetojmë përgjatë dy linjave: 1] *A përshtatet me faktet?* A e mbështesin të dhënat aktuale të feve dhe të përvojës fetare pretendimin pluralist? 2] *A ka kuptim?* A ka lidhje logjike dhe a është i qëndrueshëm si një zgjidhje alternative ndaj problemit të larmisë fetare?

A PËRSHTATET ME FAKTET?

Problemi i parë i madh me të cilin pluralistët duhet të përballen është *problemi i pretendimeve kontradiktore të së vërtetës*. A kanë të gjitha fetë e ndryshme në thelb të njëjtin pretendim dhe a mësojnë në parim të njëjtën të vërtetë? Edhe një vështrim i përciptë i feve botërore në përdorim sot zbulon se ato kanë ndryshime të dukshme në pohimet e tyre thelbësore. Le ta ilustrojmë këtë duke

krahasuar tri besime kryesore të tri prej feve kryesore të botës.

Si është Perëndia [themeluesi fetar]? Allahu është Perëndia krijues i vetëm i përjetshëm në fenë islame. Myslimanët e konsiderojnë si idhujtari çdo përpjekje për ta megjulluar dallimin midis Krijuesit dhe krijimit. Për sa i përket budizmit, nuk ekziston një koncept i vetëm për themelin fetar i cili të jetë i përbashkët për të gjithë budistët. Në budizmin Theravada, *nirvana* është realiteti përfundimtar – gjendja e ndërprerjes së plotë të afritetit ose lidhjes me botën tokësore; në budizmin Mahajana, *Dharmakaja*, Trupi Ligjor gjithëpërfshirës i esencës së Budës është përfundimtar; dhe në budizmin Zen, realiteti përfundimtar është *sunyata* ose boshllëku.

Në hinduizëm, koncepti më i lartë filozofik i realitetit përfundimtar është monistik: Qenia absolute, jo personale është *nirguna* Brahman e *advaita* Vedanta. Hinduizmi popullor nga ana tjetër, është politeist me një panteon që përbëhet nga një numër marramendës prej 330 milionë hyjnish meshkuj dhe femra. Gjithashtu brenda hinduizmit ekzistojnë edhe sekte monoteiste si edhe hindu ateistë të cilët janë puro materialistë.

Cila është natyra e gjendjes së vështirë njerëzore? Për Islamizmin, mëkati më i madh është *shirk-u*, lidhja e çfarëdolloj gjëje të krijuar me Allahun, dhe idhujtaria është qartësisht e dënueshme. Mëkati është më shumë një dobësi, një defekt ose papërsosmëri sesa një korrupsion rrënjësor i natyrës dhe vullnetit. Megjithëse ekzistojnë disa ndryshime të vogla, edhe hinduizmi edhe budizmi ndajnë besimin se njerëzimi është i futur në kurth brenda samsar-ës, një cikël i rilindjes dhe i transmigrimit i bazuar tek *karma*. Problemi rrënjësor i ekzistencës së njeriut nuk është mëkati moral, por injoranca primitive e lindur në lidhje me natyrën e vërtetë të realitetit.

Cila është natyra e shpëtimit apo çlirimit? Sipas fesë islame, një shpëtim i ardhshëm i lavdishëm i pret besnikët: Ditën e Gjykimit, Allahu do të pranojë ata të cilët ai i shpall të denjë për kënaqësitë e Parajsës. Në hinduizëm, shpëtimi është moksha – çlirim i plotë nga zinxhirët e karmës dhe nga cikli i rilindjes. Njerëzit mund ta arrijnë këtë çlirim në një nga këto tri mënyra: mënyra e veprimit vetëmohues ose të drejtë [*karma marga*]; mënyra e njohurisë mistike [*jnana marga*]; mënyra e përkushtimit ndaj një hyjnie personale [*bhakti marga*].

Të gjithë budistët e shohin shpëtimin si çlirim nga *samsara* përmes *nirvanës*, eliminimin e plotë të dëshirës dhe të gjendjeve që prodhojnë rilindje. Por ndërkohë që disa budistë e konsiderojnë këtë vetëm si rrjedhojë e përpjekjeve personale të dikujt, të tjerët e shohin përpjekjen personale si të pavlerë dhe i qëndrojnë idesë se vetëm besimi tek mëshira dhe

**Pika e
pashmangshme
e nisjes në
çdo përpjekje
për t'u
ballafaquar
drejtpërdrejt
me mesazhin
e Jezusit
duhet të jetë
gjithmonë
vetë Jezusi.**

merita e dikujt tjetër mund të sjellë ndriçim.

A është realiteti përfundimtar personal apo jo personal? A ekziston vetëm një Perëndi, shumë hyjni apo asnjë lloj Qenieje më e lartë? A është gjendja e vështirë njerëzore rezultat i mëkatit moral apo i iluzionit kozmik? A është shpëtimi në thelb një çlirim nga cikli i rilindjeve apo është premtimi i një parajse të hareshme e seksuale që iu jepet si shpërblim besnikëve?

Ekziston një larmi shumë e madhe dogmash e besimesh në fetë e ndryshme, dhe shumë pohime kryesore në fakt janë reciprokisht të papërputhshme. Kjo i detyron pluralistët që t'i drejtohen një ri-interpretimi reduktues të besimeve dhe praktikave fetare që shpesh bëhen në rrugë që janë të papranueshme nga ndjekësit ortodoksë të feve të ndryshme. Prandaj, argumenti pluralist – që pavarësisht besimeve të tyre të ndryshme (të kundërta), të gjitha fetë janë pak a shumë të vërteta në mënyrë të barabartë – është qartësisht i pambrojtshëm. Faktet thjesht nuk përputhen. Në qoftë se mbështetësit e pluralizmit duan që faktet t'i përputhen teorisë, ata duhet t'i "gdhendin" këto fakte.

A KA KUPTIM?

Një kusht thelbësor në vizionin pluralist është që, nëse fetë e ndryshme të botës do të arrinin që t'i nënshtrojnë dallimet e tyre ndarëse dhe të specifikuar nga tradita në favor të përjasjeve pluraliste, atëherë harmonia fetare do të vinte automatikisht si rrjedhojë. Teza pluraliste mbështetet mbi supozimin që nuk ka asnjë traditë fetare të privilegjuar. Një pyetje vendimtare për pluralistët është: *A ekziston vallë një përjasje e paspecifikuar nga tradita?*

Le ta testojmë këtë çështje përkundrejt pikëpamjeve të Xhon Hikut (John Hick), një ithtar modern i pluralizmit. Sipas pikëpamjeve të Hikut, hipoteza më e mirë që e shpjegon pozitivisht pluralitetin (shumësinë) fetar është: Të gjitha fetë janë shtigje drejt Reales. Në pamje të parë, kjo duket më e pranueshme për shkak se e portretizon siç duhet gamën e gjerë të feve. Realja është përfundimisht përtej të gjitha përshkrimeve dhe sigurisht nuk është ezauruar në përshkrimet e feve të ndryshme, të cilat, që të gjitha janë pjesërisht të vërteta dhe pjesërisht të rreme.⁴

Thelbi i çështjes këtu është i thjeshtë: Si e di Hiku se çfarë është e vërtetë e çfarë është e rreme tek përshkrimet e feve të ndryshme? Çfarë kriteri përdor ai për të bërë gjykime të tilla? Edhe më specifikisht, si i di Hiku të gjitha ato që ai i pohon rreth natyrës së Reales? Përkufizimi i Hikut për Realen ka për qëllim të jetë gjithëpërfshirës, por në fakt, i përjashton të gjitha format e besimit ortodoks fetar, qofshin këto të krishtera apo të tjera, të cilat mund të pretendojnë se Realja e ka zbuluar veten. Por si i refuzon dhe si i trajton ai të gjitha pretendimet e kundërta si të rreme? Ai e bën këtë duke u bazuar në vijën e nisjes së modernizmit liberal të specifikuar nga tradita, i influencuar nga monizmi mistik lindor.

Dhe kjo është pika ku projekti pluralist dështon shumë keq: supozimi i gabuar se është e mundur të kesh një pikë epërsie të lartë mbi të gjitha fetë, nga e cila mund të formulosh kritere teologjike të jashtëzakonshme e neutrale për të vlerësuar pretendimet fetare për të

©2014 Paul F. Gray



Kush tha që nuk jam i përkushtuar sa duhet...?!
Kush këtu ka kryq më të madh se i imi...!!

vërtetën. Fakti është që nuk ekziston asnjë vend i tillë i lartë e i privilegjuar në asnjë vlerësim teologjik të pretendimeve fetare për të vërtetën. Ashtu si të gjitha pretendimet fetare për të vërtetën, edhe pretendimet pluraliste për të vërtetën janë, në mënyrë të pashmangshme, të specifikuar nga tradita. Në këtë mënyrë, kjo është dobësia më serioze e pozicionit pluralist: paqëndrueshmëria e madhe në logjikën e argumentit që vjen si pasojë e përpjekjeve të saj për të mohuar të drejtën e feve të tjera për të bërë ndonjë pretendim të privilegjuar ndërkohë që vetë pluralizmi përdor kritere të specifikuar nga tradita gjatë vlerësimit të besimeve fetare.⁵

Duke qenë se të gjithë pluralistët janë të përkushtuar që të ruajnë një formë të kriterit të së vërtetës të specifikuar nga tradita, atëherë asnjë gjë që quhet pluralizëm nuk ekziston në të vërtetë. Kur e demaskojmë ideologjinë pluraliste, e shohim atë ashtu siç është – një ideologji fetare sinkretike e cila bën pretendime ekskluzive të së vërtetës rreth natyrës së realitetit, njësoj si çdo sistem tjetër i besimit fetar.

KRISHTI I PAKRAHASUESHËM – ARMIKU VENDIMTAR I PLURALIZMIT

Pika e pashmangshme e nisjes në çdo përpjekje për t'u ballafaquar drejtpërdrejt me mesazhin e Jezusit duhet të jetë gjithmonë vetë Jezusi: Çfarë tha Jezusi? Çfarë deklaroi Jezusi se bëri? Kush pohoi Jezusi se ishte? Portreti i Dhjatës së Re për Jezusin është portreti i një njeriu të pashoq. Lindja e tij ishte e mrekullueshme. Ai pohon se është Perëndia: ka autoritet për të falur mëkatet, për t'u dhënë jetë të vdekurve, dhe për të gjykuar botën. Ai parashikon vdekjen dhe ringjalljen e Tij dhe më pas e plotëson parashikimin. Ata të cilët dokumentuan detajet e jetës së Jezusit ishin të bindur se Ai ishte Perëndia në mish, dhe që me jetën, vdekjen dhe ringjalljen e Tij, Perëndia ka siguruar shpëtim për të gjithë njerëzit.

Nëse ne e dyshojmë, për çfarëdo arsye, besueshmërinë e Dhjatës së Re dhe dëshmia e saj për jetën dhe shërbesën e Jezusit nuk na bind, atëherë thjesht duhet të jemi të lirë të largohemi nga Krishti dhe nga besimi i krishterë. Nuk kemi asnjë të drejtë që të zgjedhim fakte në mënyrë arbitrare nga gjërat e regjistruara në Dhjatën e Re dhe të formojmë një Jezus sipas imagjinatës sonë i cili mund të përshtatet brenda supozimeve tona të parafabrikuara. Kjo është pikërisht ajo që përpiqen të bëjnë të krishterët pluralistë por nuk arrijnë që ta bëjnë këtë gjë në mënyrë bindëse, sepse pluralizmi takon armikun e tij fatal kur vjen ballë për ballë me Krishtin e pakrahasueshëm, i cili e shpalli veten e tij se ishte

“rruga, e vërteta dhe jeta” (Gjoni 14:6).

Si ndjekës të Jezus Krishtit, ajo që kemi për t'iu thënë të tjerëve nuk është në thelb një bashkësi të vërtetash të përvetshme apo një sistem etik të sofistikuar, por një histori – historinë e Tij – historinë e Jezusit. Këtë histori nuk e shpikëm e as nuk e krijuam neve. Perëndia na e ka besuar neve, dhe ne nuk kemi asnjë të drejtë që ta ndryshojmë apo ta mbajmë për veten tonë. Ne bëjmë më të mirën tonë për t'ua thënë fqinjëve të besimeve të ndryshme këtë histori në mënyrë të përvulur, me ndjeshmëri dhe pa kurrfarë detyrimi (1 e Pjetrit 3:15). Duhet të jemi të gatshëm për ta praktikuar tolerancën me të tjerët, ndërkohë që iu lejojmë atyre të njëjtën liri për të praktikuar besimin që ata kanë siç do të donim për veten tonë.

Gjithashtu nuk duhet të hezitojmë që të pranojmë çdo rreze vërtetësie, mirësie apo bukurie që vëzhgojmë në përkushtimin, kulturën apo stilin e jetesës së njerëzve të besimeve të tjera. Por nuk duhet të rreshtim kurrë së shpalluri: “Atë që ishte nga fillimi, atë që kemi dëgjuar, atë që kemi parë me sytë tanë, atë që kemi vështruar dhe që duart tona e kanë prekur lidhur me Fjalën e jetës” (1 e Gjoni 1:1) – Krishtin tonë unik e të pashoq, Shpëtimtarin e botës.

Shënime

1. *The New York Times* [27 nëntor, 2001].
2. Libri i Mark Juergensmeyer *Terror in the Mind of God: The Global Rise of Religious Violence* ofron depërtime drithëruese në botëkuptimin e kulturave të pangjashme të dhunës fetare dhe fanatizmin e pafund të besimtarëve të vërtetë brenda të gjitha traditave kryesore të botës, duke përfshirë, krishterimin, islamizmin, hinduizmin, judaizmin, budizmin, sikizmin (London: University of California Press, 2000).
3. Harold Netland, *Encountering Religious Pluralism: The Challenge to Christian Faith and Mission* (Leicester: Apollos, 2001), 13,14.
4. Netland, 221–31.
5. Shih kritikën e mprehtë të Gavin D'Costa-s në librin *The Meeting of Religions and the Trinity* (New York: Orbis, 2000), 19–47.



IVAN SATYAVRATA, Ph.D.,
Pastor kryesor i Asamblesë së Perëndisë në Kalkuta, Indi, dhe ish-president i Kolegjit Biblik të Azisë Jugore në Bangalor, Indi.

UNGJILLI SIPAS GJONIT 3:16

Nga: CRAIG KEENER



**Nëse duam ta
kuptojmë
plotësisht këtë
varg, atëherë
duhet ta
dëgjojmë në të
njëjtën mënyrë
siç e dëgjo
publiku i parë i
Gjonit – në
kontekstin e të
gjithë Ungjillit
Sipas Gjonit.**

Kam filluar të flas për ungjillin me njerëz të tjerë vetëm pak kohë pasi kisha pranuar Krishtin. Shumë shpejt mësova që mënyra se si e shpjegoj unë procesin e shpëtimit, varet nga ajo çfarë unë vetë besoj rreth shpëtimit. Ndër të gjitha doktrinat që janë të rëndësishme për t'i njohur mirë, doktrina e shpëtimit është një nga më të rëndësishmet.

Gjoni 3:16 është një varg i njohur rreth shpëtimit. Ne shpesh e citojmë atë pa marrë parasysh mësimet që na jepen përmes tij. Nëse duam ta kuptojmë plotësisht këtë varg, atëherë duhet ta dëgjojmë në të njëjtën mënyrë siç e dëgjo publiku i parë i Gjonit – në kontekstin e të gjithë Ungjillit Sipas Gjonit. Temat tek Gjoni 3:16 theksojnë disa pika që kanë lidhje me shpëtimin, të cilat rishfaqen në mënyrë të përsëritur gjatë gjithë librit të Ungjillit Sipas Gjonit. Ndër këto tema përfshihen: natyra e dashurisë së Perëndisë, domethënia e botës, si e dha Perëndia Birin e Tij, kush është Biri i Tij, çfarë përfshin besimi që të shpëton, tek cili duhet të qëndrojë besimi që të shpëton dhe çfarë do të thotë jetë e përjetshme.

1. Perëndia deshi.

Shkaku përfundimtar i shpëtimit, siç paraqitet tek Gjoni 3:16, është dashuria e Perëndisë. Perëndia nuk ishte i detyruar nga ana morale që të shpëtonte një botë që ishte rebeluar kundër krijuesit të saj, por dashuria që e motivoi Atë të na krijonte, e motivoi që të na ripërtërinte në një marrëdhënie pozitive me Të.

Çfarë kuptimi ka kjo dashuri? Disa përqasje rreth shpjegimit të kësaj dashurie janë kundërproduktive. Për

shembull, shumë libra përmendin idenë e fjalëve të ndryshme në greqishten e lashtë për fjalën “dashuri” tek Ungjilli i Gjonit. Megjithatë, në kohën kur Gjoni shkroi ungjillin e tij, njerëzit i përdornin këto fjalë në mënyrë të ndërkëmbyeshme mes tyre; pa i trajtuar si fjalë me ndryshime të mëdha me njëra-tjetrën. Asnjë fjalor nuk është në gjendje të na e shpjegojë siç duhet këtë dashuri, qoftë ai fjalor greqisht, shqip apo i ndonjë gjuhe tjetër. Përkundrazi, shembulli i dashurisë së Perëndisë e mbush këtë fjalë me më shumë kuptim sesa do të mund të mbartte në vetvete.

Për shembull, njohuria se sa shumë e do Ati Birin na ndihmon të kuptojmë dashurinë e Tij për botën, sepse nga dashuria Ai dha Birin e Tij për botën. Ungjilli i Gjonit e thekson vazhdimisht dashurinë reciproke midis Atit dhe Birit. Për shembull:

- Ati e do Birin e Tij, i cili është me të vërtetë i bindur (10:17).
- Ati e do shumë Birin e Tij dhe ia beson Atij të gjitha (3:35).
- Ati e do Birin e Tij përjetë (17:24).
- Biri e do Atin kaq shumë sa që i bindet urdhërimit të Atit për të dhënë jetën për botën (14:31).

Dashuria që përshkruan Gjoni zbulon një marrëdhënie shumë të afërt, një



afekcion të shprehur në sakrificë vetëmohuese.

Fëmijët dhe prindërit që kanë dashuri për njëri-tjetrin mund t'i përshtaten përshkrimit që Gjoni i bëri dashurisë hyjnore, edhe pse dashuria jonë nuk mund të jetë më shumë sesa një hije e dashurisë reciproke midis Atit dhe Birin.

Referenca e parë e dhënë në mënyrë shumë të qartë për fjalën dashuri tek

Ungjilli Sipas Gjonit shfaqet tek Gjoni 3:16 – dashuria e Perëndisë për botën. Vetëm dashuria e Perëndisë për botën e shpjegon arsyen përse do ta dërgonte Birin e Tij të dashur, të cilin e donte pafundësisht dhe përjetësisht, që të vdiste në kryq. Që askush të mos dyshojë për këtë, Jezusi na mëson që Ati e deshi botën njësoj siç deshi Birin e Tij (v. 17:23). Përballë asaj që Perëndia sakrifikoi, të dyshosh për dashurinë e Perë-

**Dikur edhe unë
kam qenë një ateist,
por dashuria e
Perëndisë e
transformoi
zemrën time.**

ndisë ndaj nesh është mosbesim që lëndon zemrën e Tij.

Për të shpëtuar botën që Ai e donte, Perëndia ishte i gatshëm të duronte dhimbjen e humbjes së Birit të Tij. Kryqi e bën dashurinë të besueshme. Shumë nga ateistët ose agnostikët e kanë të vështirë të imagjinojnë një Perëndi që do. Ata ndjejnë tmerr nga intensiteti i vuajtjeve të botës, por e anashkalojnë Perëndinë që zgjodhi të përqafoje vuajtjen në kryq.

Dikur edhe unë kam qenë një ateist, por dashuria e Perëndisë e transformoi zemrën time. Bashkëshortja ime, e cila ka vuajtur për 18 muaj si refugjate në Kongo, përjetoj mundime të mëdha, por dëshmon se ishte vetëm dashuria e Perëndisë që i dha asaj forcën për të rezistuar.

2. Perëndia e deshi botën.

Bota është objekti i shpëtimit. Perëndia nuk deshi vetëm Birin e Tij të bindur, por gjithashtu edhe botën që nuk e njihte dhe që e kundërshtoi Atë.¹ Dashuria e Perëndisë për tërë botën na kujton se Ai dëshiron që të gjithë të besojnë tek Jezusi dhe të marrin shpëtimin.

Disa nga bashkëkohësit e Jezusit nënvizuan dashurinë e veçantë që Perëndia kishte për Izraelin ose për të drejtin, por ata nuk e panë se Perëndia i donte të gjithë. Megjithatë, në kapitullin që vjen pas Gjoni 3:16 disa samaritanë filluan të kuptojnë. Ata e njohën Jezusin si Shpëtimtarin e botës (4:42; krah. 1 e Gjoni 4:14). Termi “bota” përfshiu edhe samaritanët, të cilët përçmoheshin nga shumica e hebrenjve. Nëse përfshiu samaritanët, atëherë i përfshiu gjithashtu të gjithë popujt e tjerë, përfshi këtu edhe ata të cilët mund të tundohemi t'i përçmojmë sot.

Mund të na duhen më shumë përpjekje për ta sjellë dritën e Perëndisë tek ato grupe njerëzish të cilat janë të mbështjella në errësirë, por nuk ka asnjë grup njerëzish dhe asnjë individ përtej gardhit të dashurisë së Perëndisë. Jezusi e derdhi gjakun e Tij për të gjithë. Nëse ne e nderojmë sakrificën e Tij, atëherë do të duam e do të shërbejmë përtej kufijve etnike, kulturore e fetare.

“Për shkak se Perëndia e dha Birin e Tij për botën”, nuk do të thotë se cilido është i shpëtuar; do të thotë se shpëtimi është i disponueshëm për këdo. Gjoni 3:17 thekson se qëllimi i Perëndisë kur dërgoi Birin e tij nuk ishte për ta dënuar botën; ajo tashmë ishte e dënuar. Përkundrazi,

Ai e dërgoi Birin e tij që ta shpëtonte botën. Jezusi është sakrifica që e zbut zemërimin e Perëndisë për mëkatet, jo vetëm tonat, por edhe ato të të gjithë botës (1 e Gjoni 2:2). Shpëtimi është për “këdo që beson”.

Ne duhet të jemi të motivuar për t'ua dhënë lajmin e mirë njerëzve sepse Perëndia dëshiron që të gjithë ta marrin shpëtimin. Kur mendojmë për grupet e njerëzve që nuk janë arritur ende, kujtojmë se Jezusi e pagoi tashmë çmimin për shpëtimin e tyre. Megjithatë, ata gjithsesi duhet të besojnë që të shpëtohen. Kjo domosdoshmëri na fton që ta ndjekim shembullin sakrifikues të Zotit tonë për të bërë gjithçka që është e nevojshme për t'u çuar atyre që nuk janë shpëtuar, mesazhin se Perëndia i do ata aq shumë saqë dha Birin e Vet.

3. Perëndia dha.

Dashuria e Perëndisë motivoi shpëtimin, por dhënia e Birit të Tij ishte ajo që e bëri të disponueshme. Ne shpesh e lexojmë togfjalëshin “Perëndia e deshi aq botën” sikur të kishte kuptimin “Perëndia e deshi kaq shumë botën”. Në të vërtetë, aty nënkuptohet sa e madhe ishte dashuria e Perëndisë. E megjithatë, fjala “houtos” në greqisht, që këtu është përkthyer “aq”, nuk do të thotë “kaq shumë”. Por do të thotë: “në këtë mënyrë”. Pra, vargu thotë: “Kjo është mënyra se si e deshi Perëndia botën”. Perëndia nuk tha thjesht, në mënyrë abstrakte: “Të dua”. Duke ofruar Birin e Tij, Ai na dha manifestimin final të dashurisë.

Cili është kuptimi tek Gjoni 3:16 kur thuhet se Perëndia “dha” Birin e Tij? Gjoni 3:14 na shpjegon se Jezusi do të “ngrihet lart”. Jezusi u tha armiqve të Tij se ata do ta ngrinin lart (8:28). Më vonë, Jezusi premton se do ta tërhiqte botën tek vetja nëse ngrihet lart. Gjoni e shpjegon: “Jezusi e tha këtë për të zbuluar mënyrën se si do të vdiste” (12:32, 33, përkthimi i autorit). Që do të thotë se Perëndia e dha Birin e Tij duke i lënë armiqet e Tij që ta kryqëzonin. Shprehja “ngrihet lart” i bën jehonë vargut tek Isaia 52:13. Shërbëtori i Perëndisë do të ngrihej lart. Isaia 53 përshkruan sakrificën e shërbëtorit të përvuajtur.

Perëndia na do gjithmonë, por Gjoni 3:16 i referohet një vepre specifike dashurie. Koha e foljes që përdori Gjoni edhe për foljen “deshi”, edhe për foljen “dha” (koha aoriste në greqisht) ka shumë gjasa që të nënkuptojë një veprim të vetëm.

**Besimi shpëtues
nuk është thjesht
një besim
ngulmues; atij i
duhet një objekt
specifik. Të kesh
thjesht besim fetar
të përgjithësuar
nuk të shpëton.**





**Jezusi na fton në
një nivel më të
lartë besimi:
“Lum ata që
besuan edhe pse
nuk panë me sy”.**

Perëndia i dha botës Birin e Tij, duke bërë që Jezusi të jepte jetën e tij për ne në kryq. Ashtu siç sakrifikohej një qengj si flajm për mëkat, Jezusi e heq mëkatet e botës (Gjo 1:29). Dhe kështu, Jezusi vdiq në vend të botës (krah. 11:51, 52).

4. Perëndia dha Birin e tij të vetëmlindur.

Termi që është përshtatur me fjalët “i vetëmlindur” ishte veçanërisht i përshtatshëm për një fëmijë që duhej më shumë, zakonisht fëmija i vetëm i dikujt. Burimet e lashta hebraike e përdorën këtë term për të nxjerrë në pah bindjen e Abrahamit ndaj Perëndisë, kur ai ishte i gatshëm që të sakrifikohej Isakun, birin e tij të dashur. Ky përshkrim për Jezusin ripërsërit madhësinë e dashurisë sakrifikuese të Perëndisë që e dha Jezusin për ne. Disa burime hebraike, Mesian që do të vinte, e mendonin tashmë si “birin” e Perëndisë, por Gjoni këtu, e mendon “Birin e Perëndisë” në një mënyrë të veçantë, në bazë të marrëdhënies së përjetshme të Jezusit me Atin.

Fakti që Gjoni 3:16 e nënkupton birësinë e Jezusit në këtë kuptim të veçantë bëhet i qartë në pika kyçe në të njëjtin ungjill. Gjoni e konturon parathënien e tij duke nënvizuar se Jezusi është edhe Perëndi, edhe shumë afër me Atin, d.m.th, Jezusi është i dallueshëm nga Ati, por duke qenë Perëndia-Bir. Tek Gjoni 1:1, Fjala ishte Perëndi dhe ishte me Perëndinë, dhe tek 1:18 “i vetëmlindur” Perëndi, Jezusi, është në gjirin e Atit. Po ashtu, nga fundi i këtij ungjilli, Thomai e rrëfen Jezusin si Zotin dhe Perëndinë e Tij (20:28). Gjoni e shkruan ungjillin e tij në mënyrë që dëgjuesit e vet gjithashtu të mund të besojnë se Jezusi është Biri i Perëndisë (20:31).

Ne duhet ta përsërisim thelbin e Birit “të vetëmlindur” që gjendet tek Gjoni 3:16. Duke specifikuar se Ai që Perëndia dha, ishte Biri i Tij “i vetëmlindur”, Gjoni nxjerr në pah dashurinë e pamase që Perëndia pati për botën duke i dhënë asaj Jezusin.

5. Kushdo që beson.

Megjithëse vdekja e Jezusit e siguron shpëtimin për të gjithë, vetëm disa e përvetësojnë atë shpëtim. Perëndia e siguroi shpëtimin për botën me një kosto të madhe për veten e Tij. E megjithatë, shpëtimi i një individit nuk është diçka automatike. Ky varg deklaroi se njerëzit gjithsesi duhet ta pranojnë dhuratën e Tij. Ne duhet të “besojmë”, që do të thotë, t’i zëmë besë vërtetësisë së dhuratës ose të mbështetemi tek

dhurata. Vdekja e Krishtit e siguron shpëtimin në mënyrë objektive. Pranimi i Jezusit me anë të besimit na lejon ta përvetësojmë, në mënyrë subjektive, atë që Ai ka siguruar për ne.

Disa njerëz kanë ofruar një mesazh tërheqës, se të gjithë do të shpëtohen. Është e kuptueshme se përse njerëzit duan ta besojnë këtë. Megjithëse Perëndia do që të gjithë të shpëtohen dhe ne nuk e kemi gabim që të duam të njëjtën gjë, neglizhimi i mënyrës që Perëndia ka siguruar për shpëtimin ka si pasojë të kundërtën: e errëson të vërtetën rreth shpëtimit. Tek Gjoni 3:18, mësojmë se njerëzit qëndrojnë nën gjykim derisa ta vendosin besimin e tyre tek Biri i Perëndisë. Perëndia e siguroi dhuratën për të gjithë, por duhet ta pranojmë dhuratën e Tij (dhe të punojmë për t’u siguruar që edhe të tjerët të kenë mundësinë për ta pranuar).

Disa të tjerë i kushtojnë vëmendje fjalës “beson”, që përdoret këtu nga Gjoni, por lexojnë brenda saj disa ide tërheqëse që në të vërtetë nuk janë aty. Për shembull, disa pohojnë se nëse dikush beson në një moment të caktuar, ai/ajo do të shpëtohet pavarësisht nëse vazhdon ose jo të besojë tek Jezusi. Megjithatë, zakonisht koha e tashme e përdorur tek Gjoni 3:16 për foljen “beson” (pisteuon) nënkupton një besim në vazhdimësi.

Për më tepër, pikëpamja se nuk është e nevojshme për besimin që të jetë i vazhdueshëm e shpërfill kontekstin e Gjoni 3:16. Më herët, para këtij vargu, shumë njerëz në Jerusalemin shenjat që bëri Jezusi dhe “besuan” tek Ai. Megjithatë, Jezusi nuk e shkëmbeu besimin e tyre, sepse e dinte ç’kishte brenda tyre (2:23-25).

Të qenit i mahnitur nga Jezusi nuk është në vetvete besim shpëtues. Më vonë, po në këtë ungjill, disa nga dëgjuesit e Jezusit “besojnë” tek Ai – por besimi i tyre është i përkohshëm. Nga fundi i të njëjtit kapitull, ata duan ta vrasin me gurë (8:30, 59). Jezusi i paralajmëroi se vetëm nëse do të vazhdonin të ecnin në mësimet e Tij, do të mund të bëheshin dishepujt e Tij (8:31) – por ata, siç është fare e qartë, nuk vazhduan. Që besimi të jetë i vërtetë edhe shpëtues, ai duhet të jetë ngulmues deri në fund. Përndryshe, kandidatët për dishepuj bëhen si shermende të thara që nuk janë të dobishëm për hardhinë, por shërbejnë vetëm për t’u prerë e për t’u djegur (15:6).

Përgjatë viteve, disa nga miqtë e mi të ngushtë janë larguar nga besimi i krishterë. Njëri prej tyre u konvertua në një fe tjetër; një tjetër u bë agnosticist. Do të më pëlqente shumë të besoja që ata qëndrojnë të shpëtuar edhe në gjendjen e tyre aktuale, megjithatë, kjo del në kundërshtim me Gjoni 3:16 dhe një numër vargjesh të tjera që nga letrat e Palit, tek Hebrenjve e deri te Zbulesa.²

6. Beson në të.

Besimi shpëtues nuk është thjesht një besim ngulmues; atij i duhet një objekt specifik. Disa njerëz argumentojnë që mjafton që dikush të besojë në diçka, dhe ai person do të shpëtohet. Por, të kesh thjesht besim fetar të përgjithësuar nuk të shpëton. Gjoni 3:16 e përshkruan besimin shpëtues si besim “në të” – në Jezusin si Biri i Perëndisë. Disa njerëz i

afrohen besimit në Të më shumë se disa të tjerë. Për shembull, myslimanët ndajnë bashkë me të krishterët besimin se Jezusi ishte një profet dhe mrekullibërës i lindur nga një virgjreshë; ky lloj respekti për Zotin tonë u jep myslimanëve dhe të krishterëve goxha interesa të përbashkëta. Mirëpo, Gjoni shpall se besimi shpëtues pohon se Jezusi ishte më shumë sesa një profet apo mrekullibërës.

Përgjatë gjithë ungjillit, Jezusi e zbulon identitetin e Tij, shpesh me deklarata të qarta “unë jam”; për shembull, bariu ose hardhia (10:11; 15:1). Në disa raste tek ungjilli, njerëzit gjithashtu dallojnë të vërtetë rreth identitetit të Tij: Jezusi është qengji i Perëndisë (1:29, 36); Biri i Perëndisë dhe mbreti i Izraelit (1:49); dhe i shenjtë i Perëndisë (6:69). Por ungjilli kap pikën kulminante me pohimin e Thomait që Jezusi është Zot dhe Perëndi (20:28).

Jezusi e përkufizon rrëfimin e Thomait si besim: “A besove për shkak se ke parë? (20:29, përkthim i autorit). Besimi i Thomait ka përmbajtjen e duhur: Jezusi është Zoti ynë dhe Perëndia ynë. E megjithatë, Jezusi na fton në një nivel më të lartë besimi: “Lum ata që besuan edhe pse nuk panë me sy” (20:29, përkthimi i autorit). Që do të thotë, ne që nuk e pamë Jezusin në mish mund të besojmë prapëseprapë atë që besoi Thomai, që Jezusi është Zot dhe Perëndi. Mund ta bëjmë këtë edhe pa qenë me Të në tokë sepse dishepujt e parë të Jezusit dhe Fryma janë dëshmitarë.

Kjo skenë është pika kulmore e Ungjillit të Gjonit, dhe shpjegimi kulminant i asaj që nënkupton me fjalën “besim” vargu tek Gjoni 3:16. Ai e përmbyll menjëherë pjesën më të madhe të ungjillit të tij duke shtuar, në thelb: “Unë i shkrova shenjat që kam përfshirë në këtë libër në mënyrë që ju, lexuesit dhe dëgjuesit e mi, që nuk e patë Jezusin në mish, të mund të besoni gjithsesi që Jezusi është Krishti, Biri i Perëndisë” (20:31, perifrazim i autorit). Ne ia kalojmë edhe Thomait: pa e parë Krishtin e ringjallur sy në sy, ne e njohim Atë si Perëndinë Bir. Besimi shpëtues ka një përmbajtje specifike.

Dhe si të mos e përfshijë besimi shpëtues Jezusin? Nëse do të kishte rrugë të tjera shpëtimi, përse do ta lejonte Perëndia Birin e Tij të dashur që të kalonte përmes dhimbjes së kryqëzimit mbi një kryq për ne? Vargje të ndryshme nga Dhjata e Re flasin rreth shpëtimit në mënyra të ndryshme – duke u zhvendosur nga errësira në dritë, nga vdekja në jetë, nga skllavëria në liri. Por të gjitha vargjet ndajnë një vijë të përbashkët: ne vijmë tek Perëndia përmes Jezus Krishtit. Ai e pagoi çmimin; tani njerëzit duhet të përgjigjen. Judaizmi nuk mund të na shpëtojë; Budizmi nuk mund të na shpëtojë; Islamizmi nuk mund të na shpëtojë; dhe as Krishtërimi nuk mund të

na shpëtojë. Vetëm Jezus Krishti mund të na shpëtojë. Vetëm për këtë arsye do ta jepte Perëndia Birin e Tij të vetëmlindur.

7. Kushdo që beson të ketë jetën e përjetshme.

Disa vargje përpara 3:16-tës, Jezusi foli me Nikodemin në lidhje me rilindjen nga Perëndia. Lindja e re është fillimi i një jete të re – jetës së përjetshme. Që do të thotë, ne nuk jemi shpëtuar vetëm nga gjykimi (3:18, 36), por gjithashtu jemi shpëtuar për një jetë të re. Shpëtimi nuk është thjesht ajo nga e cila jemi shpëtuar (vdekja), por ajo për të cilën jemi shpëtuar – për një jetë të re të jetuar nën Zotin e vërtetë dhe të drejtë të njerëzimit, krijesin dhe shpëtimtarin tonë, Jezus Krishtin. Ne nuk veprojmë me mirësi për të marrë dhuratën e shpëtimit; përkundrazi, mirësia është pjesë e dhuratës. Shpëtimi nga mëkati do të thotë se Perëndia, duke na shpëtuar, na dha një mënyrë të re për të jetuar.

Çfarë do të thotë shprehja *jetë e përjetshme*? Sipas Danielit 12:2, shumë hebrenj flisnin rreth “jetës së përjetshme” si jeta e botës që do të vinte, që pritej pas ringjalljes së të vdekurve në të ardhmen. Dhe kështu, shumë hebrenj prisnin për jetën e përjetshme në të ardhmen. Por në krahasim, tek Gjoni 3:16, dhe shpesh në Ungjillin e Gjonit, jetën e përjetshme e kemi në kohën e *tashme*. Kjo do të thotë se në Birin e Perëndisë, të cilin Perëndia e ringjalli prej së vdekurish, ne kemi filluar tashmë ta përjetojmë jetën e epokës që do të vijë. Akoma presim për ringjalljen e trupave tanë, por edhe tani mund të jetojmë në marrëdhënie me Perëndinë dhe njëri-tjetrin si një shijim paraprak i të ardhmes (krah. 17:3, 21).

Kjo do të thotë se bota duhet të jetë në gjendje t'i hedhë sytë nga Kisha dhe të shohë se si do të duket bota e re që na është premtuar. Ndonjëherë si të krishterë, ne jetojmë sikur nuk e kemi të drejtën tonë nga Perëndia, sepse nuk e dimë se kush jemi. Ne jemi pararoja e një epoke të ardhshme, dritat e botës së ardhshme të Perëndisë në botën e sotshme. Imagjinoni ndryshimin që mund të bënim në këtë botë nëse do të mbanim mend se në të vërtetë i përkasim botës që do të vijë, dhe jetojmë këtu për të transformuar jetë dhe për t'i përgatitur njerëzit për atë botën tjetër.

Shënime

1. Gjoni i nënvizon këto pika tek 1:10; 6:51; 15:18.
2. Shih p.sh., Marku 4:14–20; Veprat 14:22; Romakëve 11:22; 1 Korintasve 9:27; Galatasve 4:19; 5:4; Kolosianëve 1:23; 1 Thesalonikasve 3:5; 1 Timoteut 4:1; Hebrenjve 2:1–3; 6:4–6; 10:29; 12:15–29; Jakobi 5:19, 20; 2 e Pjetrit 2:20–22; Zbulesa 3:5.



CRAIG KEENER, Ph.D., është profesor i Dhjatës së Re në seminarin teologjik të Asbërit (Asbury Theological Seminary) dhe një i diplomuar i seminarit teologjik të Asambleve të Perëndisë. Ai është autor i 15 librave, përfshirë këtu *IVP Bible Background Commentary: New Testament* (me gjysmë milion kopje të shitura) dhe veprat në disa vëllime që pasuan me shtëpinë botuese Baker Academic: *The Gospel of John: A Commentary*; *Miracles: The Credibility of the New Testament Accounts*; dhe *Acts: An Exegetical Commentary*.

A photograph of a person's lower body and arms. They are wearing grey trousers and blue jeans. A dark brown leather Bible with "HOLY BIBLE" printed on it is tucked into the back pocket of the jeans. The person is using two silver metal crutches with yellow foam grips. Their hands are visible, gripping the crutches. The background is plain white.

A Është Perëndia Thjesht Një Patericë Psikologjike Për të Dobëtit?

Nga: **PAUL COPAN**

Akeni takuar ndonjëherë skeptikë të këqij apo ateistë armiqësorë të cilët duken sikur mezi presin që të kacafyten? A e keni marrë ndonjëherë në konsideratë se ndoshta diçka në familjen e tyre nuk ka funksionuar siç duhet, shpesh për shkak të figurës atërore të dështuar (ose të munguar)?

Unë e hasa një person të tillë kohët e fundit. Prindërit e këtij personi ishin rritur në një shtëpi “të krishterësh” ultra-legalistë dhe më pas ata ishin përfshirë në një shërbesë profesionale. Por babai i tij shkeli kuroren, dhe si rrjedhojë, kjo gjë solli izolim, armiqësi dhe poshtërim tek e gjithë familja.

Gjatë një debati me një ateist, filozofi i krishterë J.P. Moreland iu drejtua audiencës: “Nëse je ateist, vë bast një darkë me bërçolla se ke pasur probleme me autoritetin e një figure atërore”. Një tjetër mik, edhe ai filozof i krishterë (jep mësim në Kolegjin e Bostonit), Ronald K. Tacelli, më tregoi rreth takimeve me disa ateistë të cilët ishin veçanërisht nevrikë dhe shpirtligj. Edhe ai bëri të njëjtën lidhje: “Ata kanë probleme në familje”.

Por po ecim paksa më shpejt seç duhet.

TË PSIKOLOGJISËSH BESIMTARIN

Jemi të njohur me sfidën e zakonshme që iu hidhet besimtarëve që Perëndia nuk është asgjë më shumë sesa një ide e shpikur ose e projektuar – një iluzion foshnjor, një arratisje patetike nga realiteti për të na ndihmuar të kapërcejmë vështirësitë dhe mizoritë e jetës. Në vend të njerëzve të krijuar sipas imazhit të Perëndisë, skeptikët pretendojnë se njerëzit e kanë krijuar Perëndinë *sipas imazhit të tyre*. Filozofi ateist Pitër Reiltën (Peter Railton) iu referohet perëndive “të cilëve iu kemi dhënë jetë”.

Libri *The Essence of Christianity* (Thelbi i Krishtërimin) nga Ludvig Fojërbah (Ludwig Feuerbach, 1804–72) pohon, “Feja është ëndrra e mendjes njerëzore”. Ky nocion frymëzoi Karl Marks që ta quante fenë “psherëtimin e krijesës së shtypur” dhe “opiumi i popullit”. Po ashtu, psikanalisti Zigmund Frojd ndoqi linjën e arsytimit të Fojërbahut, duke e lidhur impulsin fetar të njerëzimit me dëshirat e nën-ndërgjegjshme. Perëndia është produkti i “iluzioneve [të tilla], përmbushjeve të dëshirave më të vjetra, më të forta dhe më urgjente të njerëzimit ... mbretërimi mirëdashës i një Providence hyjnore qetëson frikërat tona për rreziqet e jetës”.

Poezia *Invictus* (që do të thotë “i panënshtuar”) nga Uilliam Ernest Henli (William Ernest Henley, 1849–1903) mbërthen frymën e këtyre psikologjizuesve të fesë: “Unë jam zoti i fatit tim; jam kapiteni i shpirtit tim”. Skeptikët thonë se besimtarët e transferojnë përgjegjësinë personale tek një hyjni e shpikur në vend që të jenë zotër të fatit të tyre dhe kapitenë të shpirtit të tyre.

PROBLEMET ME ARGUMENTIN E PATERICËS

Cila është e meta në këtë argument? Ekzistojnë një sërë problemesh dhe shqetësimesh.

Së pari, vetë Frojdi e pranoi se “psikanaliza” e tij e fesë nuk kishte asnjë evidencë klinike që ta mbështeste. Në vitin 1927, Frojdi i rrëfeu Oskar Fisterit (Pfister) – i cili ishte një psikanalist i hershëm dhe një pastor aktiv protestant – se perspektivat e tij mbi parashikimet fetare “ishin pikëpamjet e mia personale”. Frojdi kishte shumë pak përvojë psikanalitike me besimtarë të vërtetë fetarë dhe nuk publikoi asnjë analizë të besimtarëve të bazuara mbi evidenca klinike.

Së dyti, ky argument kryen atë që quhet ‘gabimi gjenetik’, i cili është gabimi që i atribuon një besimi të vërtetën ose falsitetin mbi bazën e origjinës ose zanafillës së tij/saj. Thjesht ngaqë matematikën në filllore e mësuat nga një mësuese e vrazhdë, nuk do të thotë se ajo ju mësoi mësuesja ($2+2=4$) duhet të jetë e rreme. Apo thjesht ngaqë një njeri i cili nuk

Ndërkohë që ateistët dhe skeptikët shpesh psikanalizojnë besimtarin fetar, ata dështojnë rregullisht që të psikanalizojnë kundërshtimin e tyre ndaj Perëndisë.

është i zoti në matematikë, për fatin e tij të mirë, qëllon që të gjejë përgjigjen e duhur të një problemi të ndërlikuar matematikor, nuk mund të dalim në përfundimin se përgjigja duhet të jetë e *pasaktë*. Kur skeptikët përdorin ‘gabimin gjenetik’ kundër besimtarit, atëherë kjo kthehet në një lloj ofendimi – një argument *ad hominem* (kundër njeriut); i cili, sulmon personin dhe shpërfill argumentin.

Edhe në qoftë se të gjithë ata që besojnë tek Perëndia do i mbronin pikëpamjet e tyre për arsye inferiore ose të palogjikshme, kjo përsëri *nuk bën asgjë për të hedhur poshtë ekzistencën e Perëndisë*. E vetmja gjë që mund të reflektojë kjo është se besimet e një personi nuk janë të themeluara siç duhet, por jo domosdoshmërisht që janë të rreme.

Së treti, duhet të bëjmë dallimin midis arsytimit të besimit dhe psikologjisë së besimit. Psikologjia e besimit (mënyra se si vijnë njerëzit në besimin tek Perëndia) është një çështje e ndryshme nga arsytimi i besimit (përse ka arsye të mira për të besuar tek Perëndia). Ne mund të ofrojmë arsye të mira për ekzistencën e Perëndisë (që nga fillimi i universit ose rregullsia e imët mahnitëse e tij, nga ndërgjegjja dhe bukuria, nga argumentet historike për ringjalljen e Jezusit). Për të zbuluar nëse Perëndia ekziston ose jo, nuk duhet të shohim motivet e njerëzve, përkundrazi, duhet të dallojmë se çfarë arsyes të mira ekzistojnë për të besuar ose për të mos besuar.

Së katërti, është e çuditshme dhe e paarsyeshme që të pretendojmë se çfarëdolloj gjëje që sjell ngushëllim dhe lehtësim është e rreme. Çfarë ka për të mos ta pëlqyer supën tuaj të preferuar ose një filxhan çaji në një ditë të ftohtë? Flasim për ushqime që të ngushëllojnë, siç janë makaronat, lazanjat ose picat – ushqime që mund t’iu besojmë se do të na shijojnë kurdoherë. Qartësisht nuk ka asgjë të keqe me këtë lloj kënaqësie. Ushqimi dhe strehimi janë ngushëllues, dhe familjet e shëndetshme sjellin siguri dhe lehtësim, por kjo gjë zor se e bën ushqimin, strehimin dhe familjen të paligjshme. Atëherë, përse të supozojmë që një besim duhet të jetë i gabuar nëse qëllon të jetë ngushëllues?



Një figurë atërore ngushëlluese, megjithëse është unike për besimin biblik, nuk është në qendër të feve të tjera në botë. Mësimet e Jezusit e prezantojnë, në mënyrë unike, Perëndinë si Abba, një titull hebraik për babanë, që përdoret nga fëmijët, madje edhe kur ata janë të rritur – Ati personal i besimtarit.

Së pesti, natyra e pashërueshme fetare tek qeniet njerëzore, ka shumë mundësi, që mund të tregojë një boshllëk të vendosur në mënyrë hyjnore të cilin mund ta mbushë vetëm Perëndia. Këtu, mund ta kthejmë idenë e patericës me kokë poshtë. Nëse jemi krijuar për të shijuar Perëndinë dhe për të gjetur strehë dhe siguri në marrëdhënie me Të, atëherë nuk duhet të habitemi që vetë Perëndia e ka vendosur këtë impuls fetar brenda nesh – që Perëndia ka vendosur përjetësinë në zemrat tona (Predikuesit 3:11). Në këtë rast, një mall i tillë është një tregues i të jashtëzakonshmes. Shën Agustini u shpreh kështu: “Ti na ke bërë për veten tënde, o Perëndi, dhe zemrat tona nuk gjejnë qetësi derisa të gjejnë pushim në Ty”. Ky mall (ose kjo dëshirë e madhe) i bie të jetë një mbështetje për teizmin, dhe jo një argument kundër tij.

Për shkak se *proceset natyrore* kontribuojnë tek besimi fetar, ato nuk e hedhin poshtë ekzistencën e Perëndisë. Në fakt, të qenit të krijuar gjenetikisht të detyruar për të besuar tek Perëndia ka kuptim nëse Perëndia na ka dizenuar për ta bërë më të lehtë besimin tek Ai. Këto lloj procesesh na aftësojnë të vijmë në njohurinë personale të Perëndisë, dhe jemi në maksimumin tonë të njohjes kur aftësitë tona na drejojnë drejt besimit të vërtetë tek Perëndia. Pra, është e mundur: (a) që të ekzistojë një Perëndi personal i cili i ka krijuar njerëzit që të kenë lidhje me Të, (b) që proceset natyrore kontribuojnë pjesërisht në formimin e besimit fetar, dhe (c) që besimi tek Perëndia është, për nga ana intelektuale, në rrugën e duhur, me mendjen që funksionon siç duhet sipas planit hyjnor të dizenjimit.

Duke marrë parasysh pikën e tretë më sipër (rreth dallimit midis psikologjisë dhe arsytimit), duhet të bëjmë dallimin midis *biologjisë* së besimit dhe *arsytimit* të besimit. Ekzistenca e Perëndisë është një çështje e ndarë nga faktorët biologjikë apo psikologjikë, por Perëndia mund ta projektojë botën për t'i përfshirë këta faktorë për ta bërë besimin tek Ai më të lehtë.

Së gjashti, një figurë atërore ngushëlluese, megjithëse është unike për besimin biblik, nuk është në qendër të feve të tjera në botë. Mësimet e Jezusit e prezantojnë, në mënyrë unike, Perëndinë si Abba (një titull hebraik për babanë, që përdoret nga fëmijët, madje edhe kur ata janë të rritur) – Ati personal i besimtarit. Këtë fjalë intime e personale për Realitetin Përfundimtar, nuk e gjejmë tek fetë e tjera të mëdha botërore; shumë nga fetë e Lindjes e shohin Perëndinë si “diçka” abstrakte dhe jo personale.

Për më tepër, përse të shpikësh një Perëndi i cili është një në tre persona – Ati, Biri dhe Fryma? Dhe përse të sajosh një Hyjni të pakontrollueshëm e të

ngatërruar i cili vendos kufizime në impulset dhe egocentrizmin tonë, madje edhe do të na gjykojë? Kjo nuk i ngjan aspak perëndive e perëndeshave tepër njerëzore e me të meta të Greqisë dhe të Romës. Ashtu si Aslani (personazh libri) i C.S. Ljuisit, Perëndia i Biblës është i mirë, por nuk është i parrezikshëm.

Së shtati, përpjekja për t'i psikologjisur besimtarët iu aplikohet më lehtësisht ateistëve të thekur. Është interesante që ndërkohë që ateistët dhe skeptikët shpesh psikanalizojnë besimtarin fetar, ata dështojnë rregullisht që të psikanalizojnë kundërshtimin e tyre ndaj Perëndisë. Përse janë besimtarët e jo ateistët objekt i kësaj lloj këqyrjeje? Mbani mend edhe një tjetër tipar të psikanalizës së Frojdit – më saktë, një inat i brendshëm që dëshiron të vrasë figurën atërore.

Përse duhet të supozojmë se ateizmi është pozicioni i vendosur, i arsyeshëm dhe i shëndetshëm nga ana psikologjike ndërsa teizmi është disi i mangët nga ana psikologjike? Pol Vic (Paul Vitz), profesor psikologjie në universitetin e Nju Jorkut, e përmbys situatën në favor të teizmit ndaj një mendësie të tillë. Në thelb, ai thotë: “Le të hedhim një vështrim në jetët e ateistëve dhe skeptikëve kryesorë në të kaluarën. Çfarë gjërash kanë të përbashkëta?” Rezultati është interesant: *praktikisht të gjitha këto figura kryesore kishin mungesën e një shembulli apo modeli pozitiv atëror – ose nuk kishin fare një baba.*

Le të shohim disa prej tyre.

- *Volteri* (1694–1778): Ky kritik thumbues i fesë, edhe pse nuk ishte ateist, e refuzoi ashpër babanë e tij dhe refuzoi emrin e tij të lindjes Fransua-Mari Arouet.
- *Dejvid Hjum* (David Hume) (1711–76): I ati i këtij skeptiku skocez vdiq kur ai ishte vetëm 2 vjeç. Biografët e Hjumit nuk përmendin asnjë të afërm apo miq të familjes të cilët mund të kenë shërbyer si figura atërore për Hjumit.

- *Baroni d'Holbah* (Baron d'Holbach) (1723–89): Ky ateist francez mbeti jetim që nga mosha 13 vjeçare dhe jetoi me xhaxhain e tij.
- *Ludvig Fojërbah* (Ludwig Feuerbach) (1804–72): Në moshën 13 vjeçare, babai i Fojërbahut e braktisi familjen e tij dhe shkoi të jetonte me një grua tjetër në një qytet tjetër.
- *Karl Marks* (1818–83): Babai i Marksit, që ishte hebre, u konvertua nën presion që të bëhej luteran – dhe jo për shkak të ndonjë bindjeje fetare të tij. Si pasojë e kësaj, Marksi nuk e respektonte të atin.
- *Fridrih Niçe* (1844–1900): Ishte vetëm 4 vjeç kur humbi babanë e tij.
- *Zigmund Frojd* (1856–1939): Jakobi, babai i tij, ishte një zhgënjim i madh për të; i ati i Frojdit ishte pasiv dhe i dobët. Frojdi gjithashtu përmend faktin se babai i tij ishte një pervers seksual dhe që fëmijët e tij vuajtën për këtë gjë.
- *Bertrand Rasëll* (1872–1970): Babai i tij vdiq kur ai ishte 4 vjeç.
- *Albert Kamy* (1913–60): Babai i tij vdiq kur ai ishte vetëm 1 vjeç, dhe në romanin e tij autobiografik “Burri i Parë” (The First Man), figura e të atit është preokupimi qendror i veprës.
- *Zhan Pol Sartre* (1905–80): Babai i ekzistencialistit të famshëm vdiq para se ai të lindte.
- *Mëdelin Mërrei-O'Her* (Madeleine Murray-O'Hair) (1919–95): Ajo e urrente të atin dhe madje u përpoq që ta vriste atë me një hanxhar.

Mund të shtojmë këtu edhe disa nga ateistët bashkëkohorë më të spikatur, me sfida të ngjashme në fëmijëri, të cilët nuk janë përmendur nga Vic:

- *Daniel Denet* (Daniel Dennett) (1942–): Babai i tij vdiq kur ai ishte 5 vjeç dhe kishte shumë pak ndikim mbi Denetin.

**Argumenti
i skeptikëve,
rreth projektimit
të figurës atërore,
për të hedhur
poshtë ekzistencën
e Perëndisë
kryen gabimin
gjenetik.**



- **Kristofër Hiçëns (Christopher Hitchens)** (1949 – 2011): Babai i tij (“Komandanti”) ishte një njeri i mirë sipas Hiçëns, por ai dhe Hiçëns “nuk bisedonin edhe aq shumë”. Duke pasur dikur një “distançë të respektueshme”, marrëdhënia e tyre mori një “ftohtësi të qartë” me ndonjë “ngrohtësi rastësore”. Hiçëns thoshte: “Jam goxha shterpë për sa i përket kujtimeve atërore”.
- **Riçard Dokins (Richard Dawkins)** (1941–): Megjithëse i inkurajuar nga prindërit e tij për të studiuar në degët shkencore, ai përmend se ka qenë ngacmuar seksualisht kur ishte fëmijë – një ngjarje jo pa rëndësi, megjithëse Dokins e trajton thjesht si diçka të sikletshme.

Për më tepër, studimi i Vic vëren se sa nga teistët e spikatur në të kaluarën – si p.sh. Blez Paskal (Blaise Pascal), G. K. Çestërton (Chesterton), Karl Barth dhe Ditrih Bonhofer (Dietrich Bonhoeffer) – kishin të përbashkët në jetët e tyre një baba të dashur e të kujdesur.

Kështu që, argumenti i skeptikëve, rreth projektimit të figurës atërore, për të hedhur poshtë ekzistencën e Perëndisë kryen gabimin gjenetik. Për t'i keqësuar edhe më shumë gjërat për skeptikët dhe ateistët më të përkushtuar, zëdhënësit më të spikatur për ateizmin dhe skepticizmin kanë mbartur gjithmonë edhe ata vetë një bagazh të madh psikologjik.

Duhet t'i marrim në konsideratë meritat e argumenteve pro dhe kundër ekzistencës së Perëndisë pa i hedhur poshtë argumentet në bazë të motivit të atij ose këtij personi. Megjithatë, Vic na kujton se faktorët psikologjikë (si kujtimet e shëndetshme dhe të gëzueshme të fëmijërisë kundrejt kujtimeve të dhimbshme) mund të kenë në të vërtetë një lidhje se *si një person fillon të besojë ose të mos besojë*; këta faktorë të nën-ndërgjegjshëm kanë një peshë të madhe dhe mund të rezultojnë në pengesa psikologjike ndaj besimit. Këta faktorë mund ta bëjnë të vështirë *besimin* tek Perëndia duke qenë se personat që duhet të jenë më afër nesh janë bërë të *padenjë për besimin tonë* ose nuk janë më të pranishëm.

Kur njerëzit vijnë e më thonë se kanë vështirësi t'i besojnë Perëndisë (edhe nëse kanë arsye të mira

për të besuar tek Perëndia dhe duan që të besojnë), unë i pyes rreth historisë së tyre familjare, veçanërisht për marrëdhënien me babanë. Nga përvoja ime, përgjigja tipike është: “Po, nga e dije ti?” ose “Ke të drejtë”. Në këtë rast, siguria e një komuniteti të dashur besimtarësh të krishterë mund të luajë një rol domethënës për t'i ndihmuar njerëzit në rimëkëmbjen e aftësisë për t'i besuar Atit që na do në mënyrë të pandalshme. Besnikëria e Perëndisë është e dukshme veçanërisht tek dashuria e Krishtit dhe tek akti i dhënies së Vetes së Tij për ne (Gjoni 3:16).

ARGUMENTI NGA DËSHIRA

Mund t'i përmbledhim të gjitha këto konsiderata në një *argument nga dëshira* – një argument i cili u bë i famshëm nga C.S. Ljuis. Nevojat dhe dëshirat tona më të mëdha na dretojnë tek një Perëndi i jashtëzakonshëm, i cili mund t'i përmbushë ato përgjithmonë. Ljuis flet për “një dëshirë për diçka që në fakt nuk ka ndodhur kurrë”. Njerëzit kanë gjithfarë dëshirash – për kënaqësi seksuale, sukses atletik, pushime ekzotike, vakte gastronomike. Por pavarësisht se sa gëzim të japin këto përvoja, ne nuk marrim kënaqësi të plotë prej tyre. Kërkojmë për diçka *më shumë* – diçka *përtej*, diçka *përfundimtare*.

Ljuis shkruan rreth kërimit të përmbushjes në letërsi dhe muzikë: “Librat ose muzika, brenda të cilave menduam se lokalizuar bukurinë, do të na tradhetojnë nëse besojmë tek ato; nuk ishte *në* to, vetëm sa erdhi *përmes* tyre, dhe ajo që erdhi përmes tyre ishte dëshira e madhe. Këto gjëra – bukuria, kujtimi i të shkuarës sonë – janë imazhe të mira të asaj që me të vërtetë dëshirojmë; por nëse i ngatërrojmë ato me vetë këto gjëra, atëherë ato kthehen në idhuj gojëkyçur, duke thyer zemrat e adhuresve të tyre”.

Kënaqësitë tona tokësore nuk janë qëllime në vetvete. Dëshirat tona të papërmbushura mund të na dretojnë tek Dikush të cilin nuk mund ta zëvendësojë asnjë gjë tokësore. Ato na dretojnë në një sferë tjetër, të cilën mund të fillojmë ta ndjejmë pjesërisht tani, por një ditë do ta jetojmë në praninë e plotë e të pambuluar të Perëndisë – Atit tonë të lavdishëm e të dashur.



PAUL COPAN, Ph.D., është profesor dhe kryetar i grupit Pledger në filozofi dhe etikë në Universitetin Atlantik të Palm Beach në West Palm Beach, Florida, SHBA. Ai është autor dhe redaktor i një sërë librash, duke përfshirë *When God Goes to Starbucks*; *True for You, But Not for Me*; *That's Just Your Interpretation*; *Creation Out of Nothing*; *Is God a Moral Monster? Making Sense of the Old Testament God*; dhe, *The Paul Copan Apologetics Collection* (6 Vëllime). Ai është gjithashtu president i Shoqërisë Filozofike Ungjillore.

PËRSHTYPJE NGA KONFERENCA BALLKANIKE E TË RINJVE

Nga: PASTOR GËZIM SPAHIJA

MISION PER BALLKANIN 20-22 Mars 2015



Kurt Plagenhoef

20 vjet Misionar ne Shqiperi
Drejtor i Missionit ne KPAPSH
As/ President i KPAPSH
Drejtor i KTU

Stewart Reginald Sampson

Misionar ne Shqiperi dhe ne shume
shtete, perfshi Austri, Afrike e Jugut etj.
Themelues dhe mbjedhes Kishash.



“...Prej Jeruzalemit e perqark
gjer ne Iliri kam kryer
sherbimin e ungjillit te Krishtit”.
Romakeve 15 -19



Për të dytin vit radhazi në qytetin bregdetar të Durrësit, nga datat 20 – 22 Mars 2015 në Hotel Bonita Golem, Plazh Durrës u zhvillua nga KPAPSH, Konferenca e të Rinjve për Misionin me temë: **“Prej Jerusalemit e përqark gjer në Iliri - kam përmbushur shpalljen e Ungjillit të Krishtit”, Romakëve 15 : 19.**

U mbledhëm pikërisht në atë qytet, me emrin Dyrrah, ku edhe fillon historia e vërtetë e Kishës së Parë të themeluar nga apostulli Pal dhe drejtuar nga vëllai ynë, Anastas. Ishte një bekim i veçantë të shikoje kaq shumë vëllezër dhe motra, rreth 300 vetë, të ardhur nga drejtime e kombe të ndryshme si Shqipëria, Italia, Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia.

Adhurimi i drejtuar nga Fryma e Shenjtë, i solli të rinjtë në unitet së bashku dhe mrekullia ishte se këndohej në gjuhë të ndryshme, por me të njëjtin shpirt. Kjo u koordinua kur në takime të ndryshme drejtuan grupe të ndryshme duke na sjellë një freski në frymë.

Koha e lutjes, e kërimit të fytyrës së Zotit, e zbulimit të vullnetit të Tij, e pritjes së një përgjigjeje me lot e ngashërim, ishte shumë e veçantë dhe u pa një lëvizje e Frymës. Duke qenë se konferenca kishte në qendër Ballkanin, u kalua një kohë e veçantë për dhënien e informacionit dhe ndarje të sfidave dhe bekimeve nga drejtuesit e këtyre zonave. U lutëm për Ballkanin në tërësi dhe veçanërisht për Kosovën, konkretisht për Pastorin Astrit Morina, së bashku me një grup të rinjsh bashkëpunëtorë në shërbesën e Zotit në Gjakovë, nga Mali i Zi, motër Bukuriye Nikqi bashkë me një familje të shpëtuar në Ulqin, si dhe nga Maqedonia, Dardajan Sina dhe Rilinda Hoxha si misionarë të dërguar në Shkup.

Zoti na bekoji fuqishëm përmes Fjalës së Tij, e cila erdhi natyrshëm në ato zemra të reja, të hapura duke dëshiruar që ta marrin me padurim e zjarr këtë fjalë. **Predikuesit** Kurt Plagenhoef dhe Stjuart Samson ishin plot me vajosje dhe plot me Frymën e Shenjtë duke sjellë mesazhin e Fjalës së Zotit. Kjo u reflektua nga një përgjigje masive në apelin e fundit që bëhej për lutje në fund të predikimit.



Si rezultat i kësaj, edhe njëherë **Zoti thirri njerëz në këtë konferencë**; njerëz për t'u bërë pjesë e misionit të Tij. Një vajzë nga Italia mori thirrjen e Zotit për të shërbyer në Ballkan, dhe këtë vit do të jetë pjesë e studentëve në Kolegjin Teologjik Ungjillor (KTU). Një çift gjithashtu nga Italia u ofruan për të qenë në shërbim të Zotit ku Ai të ketë nevojë. Një pastor rikonfirmoi thirrjen e tij për të qenë pjesë e misionit të Zotit përmes investimit financiar. Dy vajza nga Shqipëria morën një përgjigje për të qenë pjesë e KTU-së. Një vëlla nga Italia gjithashtu u prek dhe dëshiron që të jetë pjesë e misionit. Shumë të rinj patën një ripërkushtim të jetës së tyre në Zotin. Prekja e Zotit ishte masive. Shumë të rinj ishin atje përpara në gjunjë duke kërkuar një përgjigje nga Zoti për drejtimin e jetës së tyre për shërbesë. Ishte shumë inkurajim që t'i shihje të rinjtë tanë me këtë dëshirë të zjarrtë. Ishte një inkurajim për kishat e KPAPSH-it që morën pjesë në këtë konferencë, dhe unë besoj se shërbesa të tilla na forcojnë jo vetëm në shërbesën tonë të përbashkët, por na japin sigurinë që së bashku mund të bëjmë gjithnjë e më shumë, dhe se së bashku jemi më të fortë.

Koha e ofertës ishte e veçantë dhe e mbushur plot me surpriza, ku në ditën e fundit Pastori Nuccio Siracusa ndjeu nga Zoti që të blihej një makinë për misionin në Maqedoni sipas nevojës e kërkesës së tyre, me ofertë të drejtpërdrejtë, por edhe me premtim. Lavdi Zotit, shuma ishte më se e mjaftueshme për blerjen e makinës që në ditën e nesërme.

Zoti është besnik dhe po thërret edhe besnikët e Tij që të jenë pjesë e ushtrisë së Zotit për të rimarrë zonat e pushtuara nga satani. Pyetja e Zotit është: *"Kë të dërgoj dhe kush do të shkojë për ne?"*. Kjo pyetje po pret çdo ditë një përgjigje. Lavdi Zotit për ata që me kurajo e besim japin përgjigjen e tyre në Zotin. Ja ku jam! Më dërgo mua Zot! A dëshiron edhe ti që të jesh pjesë e shërbesës së Zotit në Ballkan? Sot është dita për të marrë vendimin e duhur. **Zoti po pret një përgjigje nga ti!**

Pastor GËZIM SPAHIJA,
Drejtor Ekzekutiv i KPAPSH



Sa më shumë
ta pajisni
bashkësinë tuaj
që të kuptojë
doktrinën
e shëndoshë
rreth personit
të Krishtit,
aq më shumë
do t'i keni
pajisur ata
që t'u përgjigjen
me besnikëri
pyetjeve që
ngrihen nga
miqtë e tyre
myslimanë.

A ESHTË JEZUS KRISHTI BIRI I PERËNDISË?

Përgjigje ndaj Pikëpamjeve Myslimane rreth Jezusit

Nga: JOSEPH CUMMING

Kur flisni për çështjet e besimit me fqinjët tuaj jo-besimtarë, cilat dogma të krishtera kundërshtojnë ata më së shumti? A është koncepti biblik i ferrit? A janë pikëpamjet tuaja rreth martesave homoseksuale? Pagabueshmëria e Shkrimit?

Për shumë prej fqinjëve tuaj myslimanë, këto dogma të krishtera nuk janë fyese. Në fakt, fqinji juaj mysliman për shumë prej këtyre pikave mund të jetë dakord me ju. Por shumica e myslimanëve ofendohen shumë nga një tjetër dogmë që është kyçe për besimin e krishterë: pohimi që Jezus Krishti është “Biri i Perëndisë”.

Përgjatë 15 viteve, kohë në të cilën kam jetuar në një republikë islamike në botën arabe, si dhe 12 viteve të tjera duke punuar përditë me myslimanë në SHBA, kam zbuluar që shumë myslimanë e konsiderojnë këtë dogmë të krishterë më fyese se çdo gjë tjetër që besojnë të krishterët. Nëse jeni një pastor që e inkurajoni bashkësinë tuaj për t'i arritur me dashuri fqinjët e tyre myslimanë, atëherë duhet t'i ndihmoni ata të mendojnë se si të reagojnë ndaj shqetësimeve të myslimanëve rreth këtij titulli të shenjtë të Shpëtimtarit tonë.

Të përbashkëta?

Përpara se të hyjmë më thellë tek ky ndryshim i fortë midis myslimanëve dhe të krishterëve, le të kujtojmë që, në lidhje me personin e Jezusit, të krishterët kanë disa gjëra të rëndësishme të përbashkëta me myslimanët. Kurani jep mësim se Jezusi u lind nga një

virgjëreshë (Surja 19:20); se Ai është një Profet (Surja 2:136); se Ai është midis atyre që janë më pranë Perëndisë (3:45); se mesazhi që Ai përcolli ishte mesazh mirësie dhe dhembshurie (57:27); se Ai shëroi të sëmurët dhe ringjalli të vdekurit me anë të fuqisë së Perëndisë (3:49); se Ai ushqeu në mënyrë të mrekullueshme të uriturit (5:112 e në vazhdim); se Ai është tani i gjallë në qiell (3:55); dhe se në fund do të kthehet (43:61). Ia vlen të përmendet se Kurani pohon që Jezusi është Mesia dhe Fjala e Perëndisë (3:45 dhe 4:171), megjithëse shumica e myslimanëve nuk i kuptojnë këto tituj sipas mënyrës që i kuptojnë të krishterët. Myslimanët e nderojnë Jezusin. Shumica e tyre nuk ia thonë emrin pa shtuar menjëherë “pagja qoftë mbi Të” – e cila në arabisht jo domosdoshmërisht nënkupton se Ai ka nevojë për paqe, por përkundrazi, që ne e përshëndesim me respekt.



**Thuaj: Ai, Perëndia
është Një. Perëndia
absolutisht i
Përjetshëm. Ai nuk
ka lindur, dhe as
nuk lind njeri prej
tij, dhe as nuk ka
ndonjë tjetër si Ai"**

**Nëse heqim
Trininë,
mishërimin,
Kryqin dhe
Biblën nga
besimi i
krishterë,
atëherë i bie të
kemi hequr
praktikisht të
gjitha ato që të
krishterët i
konsiderojnë të
nevojshme për
shpëtimin.**

Megjithatë, në të njëjtën kohë shumë myslimanë besojnë me forcë që Jezusi nuk vdiq i varur në një kryq. Ata besojnë se Ai nuk u ringjall prej të vdekurve dhe as nuk e shleu mëkatin njerëzor, dhe besojnë që njerëzit nuk duhet ta adhurojnë si Perëndi. Në përgjithësi myslimanët besojnë se Perëndia i vetëm i Abrahamit nuk është një Perëndi në tre persona dhe nuk është mishëruar në mesin tonë. Megjithatë ata besojnë se në dorëshkrimet origjinale Dhjata e Re, Tora dhe Psalmet janë Fjala e pagabueshme e Perëndisë, shumica gjithashtu beson se njerëzit e kanë ndryshuar kaq tërësisht tekstin origjinal sa që Bibla që kemi sot nuk është më e besueshme. Megjithatë, më së shumti ata janë të vendosur në mendimin se është shumë fyese t'i referohesh Jezusit si Biri i Perëndisë.

Këto nuk janë çështje anësore. Nëse heqim Trininë, mishërimin, Kryqin dhe Biblën nga besimi i krishterë, atëherë i bie të kemi hequr praktikisht të gjitha ato që të krishterët i konsiderojnë të nevojshme për shpëtimin. Në artikuj të tjerë gjatë¹, kam sugjeruar se çfarë duhet bërë me disa nga këto çështjet e tjera. Këtu do të përqendrohem që t'ju ndihmoj juve të pajisni bashkësinë tuaj për të reaguar në mënyrë konstruktive ndaj kundërshtimeve të myslimanëve rreth titullit "Biri i Perëndisë".

Rëndësia e kontekstit

Shumica e bashkëbisedimeve mes myslimanëve dhe të krishterëve rreth kësaj teme zhvillohet në kontekst polemizues. Nëse kërkon në botën e blogjeve do të gjeni myslimanë dhe të krishterë që përdorin lloj-lloj fjalësh të ulëta për njëritjetrin rreth doktrinës së Birënisë hyjnore të Krishtit. Problemi këtu është se është shumë e mundshme të fitoni një debat ndërkohë që humbisni një mik – dhe duke e larguar atë mik nga Jezusi.

Tek Mateu 18:15, Jezusi na kujton se kur nuk biem dakord me një mik, qëllimi i bisedës sonë duhet të jetë për ta fituar "motrën ose vëllain tënd", dhe jo thjesht për të fituar debatin. Nëse i jepni bashkësisë suaj materiale apologjetike të fuqishme për të vërtetuar që Jezusi është Biri hyjnor i Perëndisë, por bashkësia juaj nuk di se si ta komunikojë këtë mesazh me dashuri, atëherë keni dështuar në pajisjen e bashkësisë suaj.

Së pari duhet t'u shtrijmë dorën fqinjëve tanë myslimanë me miqësi të thjeshta e të ngrohta. Unë nuk po them këtu se e shprehura verbale e besimit të dikujt nuk është tejet e rëndësishme – vetëm se kjo e shprehur duhet të ndodhë në një kontekst miqësie, dashurie si dhe besimi dhe respekti reciprok. Të krishterët nuk duhet të kenë aspak frikë nëse dalin mundësi për biseda rreth besimit. Ndryshe nga shumica e jobesimtarëve, shumë myslimanë ndihen të kënaqur të flasim rreth çështjeve fetare me miqtë e tyre të krishterë. Patjetër, që miqësia të jetë e vërtetë, edhe ne duhet ta shohim atë si të çmuar në vetvete, jo vetëm si një mënyrë për të arritur një qëllim.

Çelësi më i rëndësishëm për të pasur marrëdhënie me mik myslimanë është ofrimi i mikpritjes dhe pranimit i saj. Nëse një mik mysliman ndalon t'ju përshëndesë sepse i ka rënë rruga andej, gjithmonë kujtohuni t'i ofroni diçka për të ngrënë ose për të pirë. Ftojini ata dhe familjen e tyre për të ngrënë një vakt në shtëpinë tuaj, dhe pranoni ftesat e tyre për një vakt në shtëpinë e tyre. Sigurohuni që të ftoni myslimanë që kanë të njëjtën gjini si ju, ose përndryshe përfshini tek ftesa bashkëshortin (bashkëshorten) ose të afërm që kanë të njëjtën gjini. Kur t'i ftoni, sigurohuni që të mos u shërbeni mish derri, proshutë, pançetë dhe t'i qëndroni larg alkoolit. Ndoshta edhe mund t'i siguron miqtë tuaj myslimanë në ftesat që do t'u jepni se nuk do të shërbeni mish derri ose alkool.

Gjatë përvojës sime, kur unë diskutoj Birëninë hyjnore të Krishtit me një të njohur mysliman në një kontekst me polemika dhe mosbesim, asnjëri prej nesh nuk përparon që ta ndihmojë njëritjetrin për të kuptuar atë që besojmë dhe përse ajo është e rëndësishme për ne. Por kur ndërtojmë një miqësi përmes thyerjes së bashku të bukës, dhe më pas flasim me respekt rreth asaj që besojmë, papritur jemi në gjendje të komunikojmë në një mënyrë domethënëse.

Jo çfarë themi ne, por çfarë dëgjojnë ata

Kur flasim me myslimanët rreth Jezusit, duhet të mësojmë atë që ne e quajmë "komunikim i orientuar nga dëgjuesi". Ne nuk duhet të mendojmë vetëm rreth asaj që duam të themi, por gjithashtu rreth

asaj që të tjerët po dëgjojnë. Kur të krishterët përdorin shprehjen “Biri i Perëndisë”, shumica e myslimanëve dëgjojnë diçka shumë të ndryshme nga ajo që të krishterët mendojnë se kanë thënë dhe nga ajo që pohohet në Bibël. Për ta kuptuar më mirë këtë, le të shohim si fillim në Kuran dhe më pas në Bibël për të parë se çfarë thonë këto dy libra rreth termit “Biri i Perëndisë”.

Faljet e përditshme të myslimanëve përfaqësojnë recitimet e vargjeve të shkurtra nga Kurani. Shumë myslimanë recitojnë përditë Suren el-Ihlas (112), një nga kapitujt më të shkurtër në Kuran: “Thuaj: Ai, Perëndia është Një. Perëndia absolutisht i Përhershëm. Ai nuk ka lindur, dhe as nuk lind njeri prej tij, dhe as nuk ka ndonjë tjetër si Ai”. Kjo i kujton përditë myslimanët e përkushtuar që Perëndia as nuk ka lindur e as nuk lind njeri prej tij. Por çfarë do të thotë folja *walada* (“lind”) në arabisht? Megjithatë është e përafërt me foljen *yalad* (Psalmi 2:7) në hebraisht, fjala në arabisht ka një gamë më të ngushtë kuptimi – përgjithësisht i referohet lindjes fizike sipas kuptimit të fjalës përmes bashkimit seksual të mashkullit dhe femrës. Sigurisht, kjo nuk është ajo që Bibla na mëson rreth Jezusit dhe as ajo që besojnë të krishterët.

Ky kuptim i foljes *walada* (dhe i emrit që rrjedh prej saj *walad* — bir ose fëmijë) është i qartë në vargje të tjera ku Kurani adreson çështjen nëse Perëndia ka ose jo fëmijë. Surja 6:101 është një nga vargjet e shumta që thotë: “Si mund të ketë Perëndia një djalë (*walad*) kur ai nuk ka një bashkëshorte femër?”. Në mënyrë interesante, kur të krishterët arabë flasin rreth Jezus Krishtit si Biri i Perëndisë, ata përgjithësisht përdorin një tjetër term në arabisht për fjalën Bir (*Ibn*) – e përafërt me fjalën *ben* në hebraisht – e cila ka një gamë më të gjerë kuptimi sesa *walad*.

Por kjo nuk do të thotë që të krishterët arabë nuk e përdorin kurrë foljen *walada* me kuptim metaforik ose jofizik. Kredoja e Nikeas në arabisht e përdor në atë kuptim. Por kur myslimanët e përdorin këtë fjalë, pothuajse gjithmonë ata e përdorin me kuptimin fizik e të drejtpërdrejtë. Krahasimisht, Kurani shpesh e përdor fjalën *ibn* në një kuptim metaforik në shprehjen “bir i rrugës” – udhëtar që ka nevojë për mikpritje.

Pra, kur një i krishterë thotë: “unë besoj se Jezusi është Biri i Perëndisë”, shpesh ajo që dëgjon miku mysliman i të krishterit është: “unë besoj se Perëndia pati marrëdhënie seksuale me Marinë dhe fizikisht prodhuan një pasardhës të paligjshëm hyjnor-njerëzor.” Kjo është e neveritshme si për myslimanët, edhe për të krishterët. Nuk është çudi që myslimanët ofendohen nga ky titull.

Atëherë, të ndryshojmë përkthimin?

Mbi 95 për qind e problemit me titullin “Biri i Perëndisë” është më shumë një problem i keq-komunikimit, sesa një kundërshtim i doktrinës së krishterë. Me fjalë të tjera, miqtë myslimanë po hedhin poshtë diçka tjetër nga ajo që po pohojnë të krishterët.

Për shkak se kuptimi fjalë për fjalë i termit “Biri i Perëndisë” u komunikoi myslimanëve diçka kaq rrënjësisht të ndryshme nga ajo që pohon Bibla, disa njerëz sugjerojnë që ta ndryshojmë përkthimin e frazës së Dhjatës së Re “Biri i Perëndisë” (*huios tou theou*). Ata sugjerojnë që të gjejmë shprehje “dinamike të barasvlershme” (të përshtatura) të cilat do të komunikojnë më me saktësi atë që Bibla dëshiron të thotë. Megjithatë ky propozim reflekton parimet tradicionale të përkthimit, unë nuk bie dakord me të për dy arsye.

Së pari, akoma nuk kam parë një metaforë alternative që të komunikojë gamën e plotë të kuptimeve të shumëllojshme, komplekse dhe të fuqishme që lidhen ngushtë me fjalët “Atë” dhe “Bir” në Bibël (shih më poshtë për analizat e këtyre kuptimeve). Së dyti, shprehja “Bir i Perëndisë” është kaq thelbësore për Biblën dhe për traditën teologjike të krishterë sa që shumica e myslimanëve janë shumë të vetëdijshëm që kjo shprehje duhet të jetë në Bibël. Nëse e zëvendësojmë atë me një fjalë dinamike të barasvlershme, ne veç sa konfirmojmë shqetësimin e myslimanëve se të krishterët ndihen të lirë ta ndryshojnë tekstin biblik kur na përshtatet neve. Në këtë mënyrë ne e dobësojmë besueshmërinë e Biblës.

“Por para se ta hedhim poshtë me ngut këtë sugjerim, është e rëndësishme të kuptojmë se çfarë ndikimi të fuqishëm emocional ka termi “Biri i Perëndisë” tek



Shumica e myslimanëve ofendohen shumë nga një tjetër dogmë që është kyçe për besimin e krishterë: pohimi që Jezus Krishti është “Biri i Perëndisë”.

**Mbi 95 për qind
e problemit
me titullin
“Biri i Perëndisë”
është më shumë
një problem
keqkomunikimi,
sesa një
kundërshtim
i doktrinës
së krishterë.**

shumë myslimanë. Gjuhëtarët na thonë se ngjyrimet emocionale të disa shprehjeve janë të ngulitura kaq thellë në rrugët tona nervore saqë edhe nëse përpiqemi t'i vendosim një kuptim të ri një shprehjeje të caktuar, nuk do të mund ta ndajmë atë nga lidhjet e vjetra emocionale. Madje, edhe besimtarët e Krishtit, me sfond mysliman, të cilët e kuptojnë domethënien e frazës “Biri i Perëndisë” dhe e pranojnë kuptimin e saj, ndonjëherë e kanë të vështirë ta përdorin atë term. Ndjenjat (të cilat janë të zhvilluara që herët në fëmijëri) që ata i lidhin me termin “Biri i Perëndisë”, nënkuptojnë se i nxisin ata në mënyrë të pashmangshme të mendojnë rreth idesë së pasardhësit të paligjshëm nga një bashkim seksual midis Perëndisë dhe Mariës.

“A ju ofendon sugjerimi se Jezusi është fëmijë i paligjshëm? Po nocioni që Perëndia pati marrëdhënie seksuale me Mariën? Patjetër që një koncept i tillë të ofendon. Dhe në fakt duhet t'ju ofendojë. Por kjo është pikërisht mënyra se si ndihen shumë miq myslimanë, edhe pasi miqtë e tyre të krishterë janë përpjekur t'i qartësojnë se çfarë duan të thonë dhe çfarë nuk duan të thonë të krishterët me termin ‘Biri i Perëndisë’”.

Prapëseprapë këto më lart nuk janë arsye të mjaftueshme për të ndryshuar mënyrën se si e përkthejmë Shkrimin. Por janë arsye të mjaftueshme për të qenë jashtëzakonisht të kujdesshëm me mënyrën se si e përdorim këtë term me miqtë tanë myslimanë. Është më mirë që në fillim të vendoset një miqësi e ngrohtë, e ndërtuar mbi besimin dhe respektin reciprok sesa ta përdorim atë frazë në mënyrë të shkujdesur. Dhe më e rëndësishmja: Mos e përdor kurrë atë term pa shpjeguar menjëherë pasi e përdor se çfarë do të thuash dhe çfarë nuk do të thuash me të.

Çfarë do të thotë në Bibël “Biri i Perëndisë”?

Fraza “Biri i Perëndisë” ka kuptime të ndryshme në kontekste të ndryshme në Bibël. Kuptimi i parë, të cilin shumica e studiuesve të Biblës e shohin si kuptimin më të zakonshëm tek ungjijtë, është

thjesht një titull mesianik – pak a shumë ekuivalent me titullin “Mesia”, “Biri i Davidit” ose “Mbreti i Izraelit”. Mateu 26:63; Gjoni 1:49; 11:27; dhe 20:31 ofrojnë shembuj të këtij kuptimi. Origjina e kësaj shprehjeje si një titull mesianik vjen nga 2 Samuelit 7 dhe nga vargjet paralele tek 1 Kronikave 17 dhe 22. Davidi dëshironte të ndërtonte një tempull për Zotin, por Zoti premtoi se do të ngrinte një pasardhës të Davidit i cili do të ndërtonte një tempull të përjetshëm, dhe fronin e të cilit do ta themelonte Perëndia përjetë. Perëndia thotë për këtë sundues mesianik: “Unë do të jem për të një atë dhe ai për mua një bir; dhe nuk do t'ia heq përkrahjen time” (1 Kronikave 17:13).

Deri këtu, shumica e myslimanëve do të binin dakord me këtë. Në këto vargje, titulli “Biri i Perëndisë” jo domosdoshmërisht nënkupton ndonjë status hyjnor (por shih Psalmi 45:6). Thjesht do të thotë sunduesi i premtuar mesianik i cili ka një marrëdhënie të veçantë dashurie me Perëndinë. Nuk nënkupton në asnjë formë lindjen fizike. Por në vargje të tjera biblike “Biri i Perëndisë” (ose shumësi “fëmijë të Perëndisë”) ka kuptime të tjera.

Një kuptim i dytë me të cilin është përdorur ky term gjendet tek Gjoni 1:12, 13 – një nga vargjet e shumta në Bibël që iu referohet atyre të cilët besojnë tek Jezusi si “fëmijë të Perëndisë”. Është fare e qartë se kjo nuk i referohet lindjes fizike; në të vërtetë, vargu 13 e refuzon haptazi idenë e çfarëdolloj lindjeje seksuale. Përkundrazi, kjo i referohet një marrëdhënieje metaforike e frymërore të dashurisë.

Një kuptim i tretë është tek Veprat 17:28, 29, ku thuhet se të gjitha qeniet njerëzore janë, në njëfarë kuptimi, “pasardhësit e Perëndisë” (qartësisht një kuptim i ndryshëm nga ai i Gjoni 1:12). Dhe Luka 3:38 i referohet Adamit si një “bir i Perëndisë”. Përsëri, këtu duket qartë që nuk po i referohet ndonjë lindjeje fizike.

Megjithëse shumica e myslimanëve nuk do e përdornin termin “fëmijë të Perëndisë” për t'iu referuar besimtarëve në përgjithësi ose qenieve njerëzore në

përgjithësi, nga përvoja ime, në një kontekst miqësie pa polemika, shumica e myslimanëve bien dakord (me kufizime) që ky kuptim për ta nuk është fyese.

Në të vërtetë, në disa raste i kam dëgjuar drejtuesit dhe studiuesit myslimanë të përdorin termin “fëmijë të Perëndisë” për t’iu referuar besimtarëve të Perëndisë së Abrahamit ose qenieve njerëzore në përgjithësi. Po ashtu, shumica e myslimanëve nuk do i referoheshin Perëndisë si “Atë” në këtë kuptim, por jo domosdoshmërisht do t’ju dukej fyese. Në disa raste të tjera, kam dëgjuar drejtues dhe studiues myslimanë të pohojnë (me kufizime) se Perëndia është Ati ynë në kuptimin që Ai është një Sigurues i dashur, i cili kujdeset për ne, na disiplinon, na mëson dhe merr kënaqësi nga ne.

Perëndia Bir?

Ekziston një kuptim i katërt, tejet i rëndësishëm sipas të cilit Bibla e përdor shprehjen “Biri i Perëndisë” dhe ky kuptim shihet posaçërisht në një sërë vargjesh tek Gjoni. Këtu, pak a shumë termi është ekuivalent me “Fjalën e Perëndisë”, që është vetëshprehja e Perëndisë dhe manifestimi i dukshëm i Perëndisë së padukshëm.

Gjoni 1 thotë se Fjala e Perëndisë ishte përjetësisht me Perëndinë dhe është Perëndi, dhe që përmes Fjalës së Perëndisë të gjitha gjërat u krijuan, dhe që kjo Fjalë u manifestua tek Jezus Krishti, dhe që ne kemi parë lavdinë e Tij. Në vargun 18, Gjoni shton (edhe pse fjala në greqisht lë vend për përkthime të tjera): “Askush s’e pa Perëndinë kurrë; i vetëmlinduri Bir, që është në gjirin e Atit, ai e bëri të njohur”. Më pas, Gjoni e përdori termin “Bir” në këtë kuptim në një sërë vargjesh.

Tek Gjoni 5:18-26, Jezusi thotë se të gjithë duhet “ta nderojnë Birin ashtu siç nderojnë Atin. Kush nuk e nderon Birin, nuk nderon Atin, që e ka dërguar.”. Ky varg gjithashtu duket sikur konfirmon se, duke folur rreth marrëdhënies së Tij me Perëndinë, në këtë mënyrë, Jezusi ishte “duke e bërë veten të barabartë [ose

identik] me Perëndinë”. Tek Gjoni 10:30, Jezusi thotë: “Unë dhe Ati jemi një”. Dhe tek Gjoni 14:9, Jezusi thotë: “Kush më ka parë mua, ka parë Atin”.

Tekste të tilla biblike nisën një proces një shekullor reflektimi teologjik mbi marrëdhënien e Fjalës / Birit me Perëndinë Atë, duke pasur parasysh pohimin e fortë të Biblës që Perëndia është një i vetëm. Dhe kjo çoi në artikulin e asaj që ne sot e quajmë doktrina e Trinitë hyjnore. Shumë të krishterë sot, kur përdorin shprehjen “Biri i Perëndisë”, në të vërtetë ata duan të thonë “Perëndia Bir, personi i dytë i Trinitë”. Është e rëndësishme të mbajmë mend se Bibla nuk e përdor shprehjen saktësisht në atë mënyrë. Ky përdorim pasqyron formulimet e pjekura teologjike të shekujve që pasuan. Por është po aq e rëndësishme të mbajmë mend se Bibla e përdor atë shprehje në mënyra të cilat, në mënyrë të pashmangshme, të çojnë në një kuptim që Perëndia është tre në një.

Megjithëse Kurani i referohet Jezusit si Fjala e Perëndisë, shumica e myslimanëve nuk e kuptojnë këtë shprehje në atë mënyrë që e thotë Bibla. Madje, edhe në këtë pikë, është e qartë se termi biblik “Bir” nuk i referohet lindjes fizike. Ky term po përshkruan një marrëdhënie unike, të përjetshme e frymërore midis Jezusit dhe Perëndisë. Kundërshtimi i myslimanëve këtu nuk është ndaj termit “Bir” në vetvete, por ndaj idesë që Perëndia u shfaq (u manifestua) në formë njerëzore dhe që ky manifestim është Jezus Krishti.

Mbi këtë çështje mund të kemi një bashkëbisedim më konstruktiv nëse mendojmë rreth marrëdhënies së Fjalës së Perëndisë me vetë Qenien e Perëndisë. Tradita teologjike islame ka një trashëgimi të pasur të debateve të forta rreth marrëdhënies së Fjalës së Perëndisë me Thelbin e Perëndisë. Kurani, ashtu si Bibla, mëson se të gjitha gjërat u krijuan me anë të Fjalës së Perëndisë – kur Perëndia foli duke thënë “Bëhu!” (p.sh. Surja 16:40). Dhe prandaj, shumica e komunitetit sunit doli në përfundimin se Fjala e Perëndisë në vetvete është e



Në lidhje me personin e Jezusit, të krishterët kanë disa gjëra të rëndësishme të përbashkëta me myslimanët – më shumë sesa kemi me çdo fe tjetër.

përjetshme dhe e pakrijuar. Ata gjithashtu dolën në përfundimin që Fjala e Perëndisë nuk është identike me Thelbin e Perëndisë, si dhe është Perëndi dhe vetëm Perëndi; më saktë, Fjala e Perëndisë ekziston përjetësisht dhe në mënyrë të pakrijuar në Thelbin e Perëndisë. Disa teologë sunitë dolën edhe më tej në përfundimin që, duke qenë se Fjala e Perëndisë është manifestuar në Kuranin e Shenjtë, atëherë Kurani është cilësia e përjetshme dhe e pakrijuar e të Folurit tek Perëndia dhe gjithashtu shprehja e krijuar dhe e përkohshme e asaj Fjale të përjetshme.

Ekzistojnë disa ndryshime të rëndësishme midis kësaj doktrine dhe kuptimit të rrymës qendrore të krishterë rreth dy natyrave të Krishtit – natyra hyjnore (i pakrijuar) dhe ajo njerëzore (i krijuar) – si dhe e marrëdhënies së Fjalës Hyjnore / Logos me Atin. Unë nuk propozoj minimizimin apo shpërfilljen e këtyre ndryshimeve. Por ka ngjashmëri të mjaftueshme që kjo të shërbejë si një urë lidhëse për mirëkuptim, në mënyrë që kur të krishterët të shpjegojnë atë që besojnë, myslimanët të mund ta kuptojnë saktësisht atë që dëshirojnë të thonë miqtë e tyre të krishterë, pavarësisht nëse bien dakord ose jo.

Herezi të paqëllimshme

Për fat të keq, shumë të krishterë nuk kanë njohurinë e duhur rreth vetë besimit të tyre. Kur këta përpiqen t'ua shpjegojnë besimin e tyre një miku mysliman, në mënyrë të paqëllimshme, ata shprehin pikëpamje të cilat Kisha i ka cilësuar historikisht si herezi.

Për shembull, Kurani pohon se Jezusi u krijua nga pluhuri, si Adami (3:59). Si kundërpërgjigje, disa të krishterë pohojnë me vendosmëri se Jezusi nuk është në asnjë kuptim një qenie njerëzore e krijuar. Megjithatë, doktrina tradicionale e krishterë thotë që Jezusi ka dy natyra – hyjnore dhe njerëzore – të bashkuara tek një person. Natyra e Tij hyjnore (Fjala / Logos) është e pakrijuar (Gjoni 1:1). Por natyra e Tij njerëzore është në të gjitha gjërat si ne, përveç mëkatit (Hebrenjve 2:17; 4:15), i krijuar nga pluhuri dhe i përkohshëm, njësoj si ne. Tradicionalisht, mohimi i natyrës plotësisht njerëzore të Jezusit njihet ndryshe si “herezia docetiste”.

Të krishterë të tjerë, kur flasin me miq myslimanë, bien në atë që njihet si “herezia apolineare” – besimi që shpirti i Jezusit ishte hyjnor dhe ishte veshur me një trup njerëzor. Problemi me këtë besim është që nëse Jezusi nuk kishte një shpirt plotësisht njerëzor, atëherë Ai nuk ishte në të gjitha mënyrat si ne – as i tunduar si ne – e megjithatë pa mëkat.

Të tjerë të krishterë, duke kërkuar të jenë të ndjeshëm ndaj miqve të tyre myslimanë, e theksojnë kaq fort ndarjen midis njerëzores dhe hyjnores tek Krishti sa që e përshkruajnë Jezusin si asgjë më

shumë sesa një qenie njerëzore e banuar nga Perëndia. Kjo shpesh quhet “herezia nestoriane” (megjithëse Nestori në histori pati më shumë nuanca në pikëpamjet e tij).

Bisedat me miqtë myslimanë, me shumë mundësi, do ta vënë në provë bashkësinë tuaj për të parë se sa mirë e kuptojnë besimin e tyre rreth personit të Krishtit. Katër gabimet më të zakonshme në të cilat bien në mënyrë të paqëllimshme disa besimtarë të krishterë (dhe disa pastorë) janë këto si më poshtë: 1) duke harruar se Krishti në natyrën e Tij hyjnore si Logos është plotësisht Perëndi, 2) duke harruar se Krishti, në natyrën e Tij të plotë njerëzore, është nga e njëjta esencë që jemi edhe ne, 3) duke harruar se këto dy natyra janë të bashkuara në mënyrë të pazbërthyeshme (të pandashme) tek një person, dhe 4) duke harruar se ky bashkim nuk e largon dallimin midis dy natyrave.

Përmbyllje


Si pastor, sa më shumë ta pajisni bashkësinë tuaj që të kuptojë doktrinën e shëndoshë rreth personit të Krishtit, aq më shumë do t'i keni pajisur ata që t'u përgjigjen me besnikëri pyetjeve që ngrihen nga miqtë e tyre myslimanë. Dhe gjatë këtij procesi, do t'i keni pajisur gjithashtu në një nivel më të thellë për vetë jetën e besimit – sepse shpëtimi ynë varet tek personi i Krishtit. Siç kanë nxjerrë në pah edhe shumë mendimtarë të krishterë përgjatë shekujve: “Nëse Krishti nuk do të ishte Perëndi, Ai nuk do të mund të na *shpëtonte*, sepse vetëm Perëndia mund të na shpëtojë. Por nëse Krishti nuk do të ishte njerëzor, Ai nuk do të mund të na *shpëtonte* sepse vetëm dikush që është në të gjitha gjërat si ne, përveç mëkatit, mund të na përfaqësojë si kryepriфт, duke ofruar veten e tij si shlyerje për mëkatet tona. Shpëtimi i racës njerëzore varet mbi faktin që Jezus Krishti është edhe plotësisht hyjnor, edhe plotësisht njerëzor, dhe që këto dy natyra janë të bashkuara, por të dallueshme nga njëra-tjetra tek një person – tek Biri i Perëndisë.

Shënime

1. Qendra për Besim dhe Kulturë, Yale.
<http://yale.edu/faith/rc/rc-rp.htm>.



JOSEPH CUMMING, është një shërbëtar i Asambleve të Perëndisë i cili ka jetuar për 15 vjet në Afrikën e Veriut. Ai shërben si drejtor i Programit të Pajtitimit në Qendrën për Besim dhe Kulturë në Universitetin Yale.
www.josephcumming.com



PROGRESI *drejt* PJEKURISË FRYMËRORE

Nga: H. MAURICE LEDNICKY

Ecja jonë në besim është një udhëtim që zgjat gjithë jetën. Ndërkohë që *shpëtimi është i menjëhershëm, shenjtërimi është progresiv*. Ne duhet të jemi të ndjeshëm në çdo moment ndaj Frymës së Shenjtë, i cili do të na drejtojë për të ndjekur planin e Perëndisë, por gjithashtu do të na bindë për mendimet, motivet dhe veprat e këqija.

Ne jemi, në fakt, në një luftë për jetë a vdekje kundër djallit. Satani nuk dëshiron ta lëshojë kontrollin. Edhe pse ju e keni pranuar Krishtin si Zot dhe Shpëtimtar, djalli do të rreshtojë ndjekësit e tij të bindur për të vendosur, në çdo pikë të mundshme, pengesa në shtegun tuaj. *“Sepse mishi ka dëshira kundër frymës, dhe Fryma ka dëshira kundër mishit; dhe këto i kundërvihen njëra-tjetrës, që të mos bëni ato që doni”* (Galatasve 5:17). Ne po përparojmë.

Apostulli Pal e kuptoi këtë parim që kishte të bënte me jetën e tij dhe me rritjen e tij frymërore. Pasi shpalli: “që në emër të Jezusit të përkulet çdo gju i atyre që janë në qiell dhe mbi tokë dhe nëntokë, dhe çdo gjuhë të rrëfejë se Jezu Krishti është Zot, për lavdi të Perëndisë Atë,” ai vazhdon më tej, “prandaj, të dashurit e mi, ashtu sikurse keni qenë gjithnjë të bindur jo vetëm kur isha i pranishëm, por edhe më shumë tani që jam larg, veproni për shpëtimin tuaj me frikë e me dridhje, sepse Perëndia është ai që vepron në ju edhe vullnetin edhe veprimtarinë, sipas pëlqimit të tij” (Filipianëve 2:10-14). Pali e adreson përsëri çështjen e rritjes frymërore me besimtarët shumë të rinj të Korintit. “Por ne të gjithë, duke soditur fytyrëzbuluar lavdinë e Zotit si në pasqyrë, shndërrohemi në të njëjtin shëmbëllim nga lavdia në lavdi, si prej Frymës së Zotit” (2 Korintasve 3:18).

LINDJA E RE ËSHTË PËRVOJA E PARË E DETYRUAR

Të gjithë e kuptojmë këtë analogji. Lindje do të thotë jetë. Megjithatë jeta njerëzore fillon që në ngjizje (në kundërshtim nga përkrahësit e abortit të cilët janë të gatshëm të marrin një jetë që është akoma në bark), është pranuar përgjithësisht që një person e fillon jetën e tij ose të saj pasi e ka lindur nëna e vet dhe pasi foshnja fillon të marrë frymë vetë. Mrekullia e foshnjave të sapolindura kremtohet rreth e përqark botës. E thënë më thjesht, nëse nuk ka lindje, nuk do të ketë jetë.

Transferoheni këtë mendim në sferën frymërore. Jezusi i tha Nikodemit, një prej udhëheqësve të farisenjve, i cili erdhi tek Jezusi nën petkun e natës: “Në të vërtetë, në të vërtetë po të them që nëse një nuk lind përsëri [nga lart], ai nuk mund ta shohë [njohë, përjetojë] mbretërinë e Perëndisë.” (Gjoni 3:3, nënvizimet dhe kllapat janë të miat). Jezusi shpjegon më tej: “Ç’ka lindur nga mishi është mish [ajo që ka lindur nga fizikja është fizike]; dhe ç’ka lindur nga Fryma është frymë. Mos u mrekullo [mos u habit, mos u çudit] që të thashë: ‘Duhet të lindni përsëri’ [nga lart].” (Gjoni 3:6-7, nënvizimet dhe kllapat janë të miat).

Pjetri shpjegon: “Duke ditur se jo me anë gjërash që prishen, si argjendi ose ari, jeni shpenguar ... por me anë të gjakut të çmuar të Krishtit, si të Qengjit të patëmetë dhe të panjollë. Të rilindur jo nga një farë që priset, por që nuk priset, me anë të fjalës së gjallë të Perëndisë, që mbetet përjetë.” (1 e Pjetrit 1:18, 19, 23, nënvizimet të miat).

Pali shkruan se të gjithë ishim “të vdekur në shkelje dhe në mëkatë.” (Efesianëve 2:1). Mesazhi është i qartë: “lindja e re” është hapi i parë i shpengimit në Krishtin nga mëkati. Pra, si ndodh kjo? – mund të pyesë dikush. “Ç’duhet të bëj unë që të shpëtohem?” (Veprat 16:30)

1. Të pranoj Fjalën e Perëndisë si të frymëzuar, të vërtetë dhe të përshtatshme për jetën time. (Romakëve 10:17)
2. Të besoj se Jezus Krishti është Biri i Perëndisë. (Mateu 16:16)
3. Të besoj se Jezusi pagoi çmimin për mëkatet e mia. (1 e Pjetrit 3:18)
4. Të pranoj që jam një mëkatar. (Luka 18:13)
5. Të pendohem – të kërkoj falje. (Romakëve 10:9,10)
6. Të marr gëzimin dhe sigurinë e shpëtimit personal. (1 Pjetrit 1:8)

VËNIA NË ZBATIM E FJALËS SË PERËNDISË NË JETËN E PËRDITSHME

Çështja e parë për t’u marrë në konsideratë është autoriteti i Fjalës së Perëndisë në jetët tona. A mund të zgjedhim neve se çfarë duam të besojmë? Apo të vendosim mbi ato pjesë të Shkrimit, të cilave jemi të gatshëm t’iu bindemi? A na lejon fakti që ne nuk mund “t’i kuptojmë” të gjitha ato që janë në Shkrim, që të vendosim se Shkrimi i ka kaluar koha dhe është për një tjetër epokë? Absolutisht jo!

Fjala e frymëzuar e Perëndisë është autoriteti më i lartë për njeriun dhe është baza e besimit dhe e jetës sonë të përditshme. Ajo u shkrua nga më shumë se dyzet (40) autorë të ndryshëm përgjatë një periudhe 1600 vjeçare. E megjithatë, nuk ka asnjë mospërputhje brenda saj. Jo vetëm që është një tregim historik i shekujve të hershëm në historinë e njeriut, por gjithashtu shpall në mënyrë profetike atë që do të jetë në të ardhmen. Ajo është komunikimi hyjnor e personal nga Perëndia tek njeriu. Përgjatë gjithë Shkrimit, mesazhi është ai i shpengimit të Atit të dashur përmes Jezus Krishtit – që prej flijimit të parë me kafshë për mosbindjen mëkatore të Adamit dhe Evës në Kopshtin e Edenit, e deri tek ringjallja përfundimtare e të gjithë besimtarëve dhe mposhtja dhe rrëzimi i fundit i të ligut. Ajo është burimi i urtësisë për çdo rrethanë të jetës dhe nuk është vjetruar nga kulturat e ndryshueshme, sistemet politike apo kundërshtimet intelektuale.

“I GJITHË Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi, që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer (i plotë, i pjekur), tërësisht i pajisur (i furnizuar) për çdo vepër të mirë.” (2 Timoteut 3:16, 17, nënvizimet dhe shtesat janë të mia)

“Bari thahet, lulja fishket, por fjala e Perëndisë tonë mbetet përjetë.” (Isaia 40:8)

Psalmi 119 është kapitulli më i gjatë i Biblës – me 176 vargje. Ajo që është edhe më interesante është fakti që ky kapitull ndahet në 22 strofa, secila duke përfaqësuar një shkronjë nga alfabeti hebre, dhe secila përmban 8 vargje. Fëmijët e vegjël hebrej e mësonin alfabetin duke mësuar Psalmin e 119-të. Prapëseprapë, me rëndësi më të madhe është përmbajtja e këtij Psalmi – secili varg lidhet me “fjalën, dëshmitë, porositë, ligjet, dekretet, urdhërimet, statutet, gjykimet” e Perëndisë.

“E kam ruajtur fjalën tënde në zemrën time, që të mos mëkatoj kundër teje.” (Psalmi 119:11)

“Fjala jote është një llambë në këmbën time dhe një dritë në shtegun tim.” (Psalmi 119:105)

“Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon ...” (Psalmi 119:130)

Dhjata e Re ofron kuptime të thella në fuqinë e Fjalës për të udhëhequr jetët tona.

“Shenjtëroji ata në të vërtetën tënde; fjala jote është e vërteta.” (Gjoni 17:17)

“Sepse fjala e Perëndisë është e gjallë dhe vepruese, më e mprehtë se çdo shpatë me dy tehe dhe depërton deri në ndarjen e shpirtit dhe të frymës, të nyjeve dhe të palcave, dhe është në gjendje të gjykojë mendimet dhe dëshirat e zemrës.” (Hebrenjve 4:12)

“Si foshnja të sapolindura, të dëshironi fort qumështin e pastër të fjalës, që të rriteni me anë të tij, nëse vërtet keni shijuar se Zoti është i mirë.” (1 e Pjetrit 2:2-3)

**ASNJË PERSON NUK DO TË BËHET
NDONJËHERË NJË DISHEPULL I
FORTË DHE I PJEKUR I KRISHTIT
DERI KUR TA PËRVETËSOJË
FJALËN E PERËNDISË NË JETËN E
PËRDITSHME.**

**FJALA E PERËNDISË SHPALL
PARIMET QË PERËNDIA VENDOSI
PËR NJERIUN—FRYMA E SHENJTË
I ZBATON PREMTIMET NË
RRETHANAT INDIVIDUALE.**

Nëse duam që Fjala të jetë udhërrëfyese ynë, domosdoshmërisht rrjedh që duhet ta lexojmë dhe ta përvetësojmë atë. Fatkeqësisht, shumë besimtarë janë lart e poshtë me besimin e tyre thjesht sepse nuk e dinë Fjalën e Perëndisë. **Fjala e Perëndisë është vullneti i Perëndisë!** Bindjuni me kujdes udhëzimeve që Perëndia ka siguruar për ne dhe do t'i pëlqeni Atij.

PUNA E BRENDSHME E FRYMËS SË SHENJTË

Fryma e Shenjtë zbulon Krishtin dhe na bind neve për mëkatet tona; si rrjedhojë, Krishti na çon në praninë e Atit. Perëndia Atë, Bir e Frymë e Shenjtë – Trinia e Shenjtë – tre në Një janë të barabartë dhe të lavdishëm edhe në frymë, thelb dhe natyrë. Rrjedhimisht, Fryma banon tek besimtari që nga momenti i konvertimit. Megjithatë, mbushja “me Frymën e Shenjtë, pagëzimi me Frymën e Shenjtë” është një përvojë e veçantë që pason pas shpëtimit. Kjo pajisje e veçantë me fuqi gjithmonë **evidentohet fillimisht** me anë të të folurit “në gjuhë të tjera.” (Lexoni Veprat 2, 8, 9, 10, 19 për një kuptim më të mirë të pagëzimit me Frymën e Shenjtë.)

“Por do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të më bëheni dëshmitarë (të kryqëzimit dhe të ringjalljes sime) në Jerusalem dhe në të gjithë Judenë dhe Samarinë dhe deri në skajin e dheut.” (Veprat 1:8, shtesat të miat)

Këto janë fjalët e fundit të regjistruara të Jezusit pas ringjalljes dhe menjëherë përpara ngritjes së Tij në krahun e djathtë të Atit. Fryma u derdh me qëllim që besimtarët të fuqizoheshin si dëshmitarë për Krishtin Jezus. Premtimi ishte për të gjithë popujt, dhe jo vetëm për ata me trashëgimi hebraike (Veprat 2:17,18).

“Kur erdhi dita e Rrëshajëve ... Dhe befas nga qielli u bë një ushtimë, si ajo e një ere që fryn furishëm, dhe e mbushi gjithë shtëpinë, ku ata po rrinin. Dhe atyre iu dukën gjuhë, si prej zjarri, të cilat ndaheshin dhe zinin vend mbi secilin prej tyre. Kështu të gjithë u mbushën me Frymën e Shenjtë dhe filluan të flasin në gjuhë të tjera, ashtu si Fryma e Shenjtë ua jepte atyre të shpreheshin” (Veprat 2:1-4, nënvizimet të miat).

Është e qartë se çdo besimtar mund (dhe duhet) ta marrë dhuratën e Frymës së Shenjtë sipas përkrahimit në Librin e Veprave të Apostujve, dhe kjo duhet të jetë praktika e kishës së Dhjatës së Re në shekullin e 21-të. Megjithatë, është e gabuar të supozojmë se të folurit “në gjuhë të tjera” në vetvete është një mbërritje. Ajo nuk është maja – është veçse porta hyrëse drejt jetës së mbushur me Frymë. Megjithëse mund të ketë shumë për t’u theksuar për sa i përket rëndësisë për të pasur një përvojë personale të “Pentekostit”, në këtë moment lëvizim përpara drejt asaj se çfarë duhet të ndodhë pas mbushjes fillestare me Frymë.

Ndoshta lista më e saktë e punës së brendshme të Frymës së Shenjtë gjendet tek Galatasve 5:22, 23:

Marrëdhënia me Perëndinë

Dashuria
Gëzimi
Paqja

Marrëdhënia me të tjerët

Durimi (shmangia nga e gabuara, gjakftohtësia)
Mirëdashja
Mirësia (dashamirësia)

Marrëdhënia me vetveten

Besimi (besnikëria, ngulmimi)
Zemërbutesia (butesia, përulësia)
Vetëkontrolli (vetëpërmbajtja, përkore)

Duke i krahasuar “veprat” e mishit, të cilat janë shkatërrimtare (Galatasve 5:19-21) me veprat e Frymës së Shenjtë tek besimtarët individualë, Pali e përshkruan këtë proces të rritjes frymërore si “fryti i Frymës” (Galatasve 5:22). Në kulturën bujqësore që e karakterizonte kohën kur jetoi apostulli, publiku i tij i kuptoi me lehtësi nënkuptimet e analogjisë.



1. **Fryti kërkon kohë të rritet.** Të korrat nuk vijnë një ditë pasi është mbjellë fara.
2. **Pema do të prodhojë llojin e vet.** Që do të thotë, pema e bananes nuk do të prodhojë ananas ose mango.
3. **Pemës duhet t'i kushtohet një vëmendje e vazhdueshme me qëllim që të prodhojë shumë.** Prashitja, vadija, krasitja, ruajtja ndaj insekteve të dëmshme, janë të gjitha procese të nevojshme në mënyrë që një prodhim të vazhdojë nga viti në vit.

E gjitha kjo tregon se besimtari i mbushur me Frymë duhet të jetë vazhdimisht duke u rritur, duke u zhvilluar dhe duke prodhuar fryte të mira. Pali thotë se duhet të *“forcoheni me fuqi nëpërmjet Frymës së tij në njeriun e brendshëm”* (Efesianëve 3:16). Më herët folëm rreth **shfajësimit**, tani po adresojmë procesin e **shenjtërimit**, i cili vazhdon për të gjithë jetën. Shenjtërimi është puna progresive e Frymës në jetët tona, duke na çuar në një vend shenjtërimi, veçimi nga qëndrimet dhe veprimet e botës që nuk tregojnë pendesë, një vend pjekurie frymërore dhe një reflektim të imazhit të Krishtit

“...me anë të shenjtërimit të Frymës ...” (1 e Pjetrit 1:2)

“Sepse ky është vullneti i Perëndisë: shenjtërimi juaj; ...” (1 Thesalonikasve 4:3)

“Por ai vetë, Perëndia i paqes, ju shenjtëroftë tërësisht; dhe gjithë fryma juaj, shpirt e trup, të ruhet pa të metë për ardhjen e Zotit tonë Jezu Krisht.” (1 Thesalonikasve 5:23)

“...të rritemi në çdo gjë drejt atij që është kreu, Krishti” (Efesianëve 4:15)

“...njësoj me shëmbëllimin e Birit të tij ...” (Romakëve 8:29)

“Por rrituni në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht.” (2 e Pjetrit 3:18)

Ekziston një tjetër aspekt i procesit të rritjes sonë frymërore – përfshirja jonë e disiplinuar. Nuk mund të presim duarkryq për Frymën e Shenjtë që të vijë edhe thjesht të na shenjtërojë. Foshnja nuk rritet pa ushqimin dhe ushtrimet e duhura. Pali i udhëzoi besimtarët e rinj edhe në Efes edhe në Kolos, me fjalët: *“të zhvishni njeriun e vjetër”* dhe *“të vishni njeriun e ri”* (Efesianëve 4:17-32; Kolosianëve 3:1-14). Ai po iu thotë atyre: **“ju, bëjeni këtë”**. Pavarësisht nga e kaluara ime – mos harroni që shumë prej këtyre johebrenjve që kishin ardhur tek Zoti, kishin qenë më parë adhurues shumë të zjarrtë të idhujve paganë – unë personalisht jam përgjegjës përpara Perëndisë (dhe do jap llogari) për sjelljen time. Papjekuria ime frymërore nuk mund të anashkalohet si një tipar personaliteti. Në analizën e fundit, ndërsa Fryma e Shenjtë është duke punuar brenda nesh për të na ndihmuar që të arrijmë pjekurinë, duhet të jetë vullneti ynë ai që e përfundon procesin.

QËLLIMI ËSHTË TË REFLEKTOJMË SHËMBËLLTYRËN E KRISHTIT

Termi “të krishterë” u përdor për herë të parë për besimtarët në Antioki të Sirisë (Veprat 11:26). Disa studiues besojnë se qytetarët e Antiokisë, të cilët ishin të njohur për tallje ndaj të tjerëve, e përdorën këtë emër në një mënyrë nënçmuese (fyese). Në fakt, fjala që kishte për qëllim ofendimin, ishte një kompliment për këta ndjekës të Krishtit, sepse banorët e Antiokisë panë tek ata karakteristikat e Shpëtimtarit të tyre. Kjo sjellje e re ishte një largim kaq dramatik nga mënyra e jetesës që kishin pasur këta të konvertuar, sa që mbërtheu vëmendjen e popullatës. Para disa vitesh, një këngë e kohës bënte një pyetje: “Nëse do të arrestohesh për shkak se je i/e krishterë, a do të kishte prova të mjaftueshme për të të shpallur fajtor/e?”

Një nga debatet e vazhdueshme midis të Dymbëdhjetëve lidhej me “pozitën” në restaurimin (e perceptuar) të Izraelit që ishte duke ardhur (çlirimi nga autoritetet romake). Edhe pasi kishin qenë me Jezusin për tre vjet, akoma vazhdonte konkurrenca për pozitë dhe spikatje. Ky debat i nxehtë vazhdoi edhe atë natë që Zoti do të merrej si i burgosur, madje pikërisht në dhomën ku ata ishin pjesë e Darkës së Fundit (Luka 22:24). Gjoni, në ungjillin e tij, dokumenton mësimin e ilustruar që Krishti iu dha dishepujve të tij atë natë. Ne shpesh i referohemi këtij mësimi si “larja e këmbëve” (Gjoni 13:1-17). Pasi i udhëzoi që ata duhej të ishin shërbëtorë dhe se Ai iu kishte siguruar atyre një shembull për t’u ndjekur, Jezusi bën një shpallje befasuese. Fill pas kësaj Ai shpjegon ndikimin që ky urdhërim do të ketë

tek bota. “Po ju jap një urdhërim të ri: ta doni njëri-tjetrin; sikurse unë ju kam dashur ju, ashtu edhe ju ta doni njëri-tjetrin. Prej kësaj do t’ju njohin të gjithë që jeni dishepujt e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin” (Gjoni 13:34,35, nënvizimet të miat). Imazhi i vërtetë i Krishtit shihet në mënyrën se si dashuria e Tij manifestohet brenda nesh dhe përmes nesh. Ne e rrokim këtë të vërtetë me dëshirë. Por, ajo që duket veçanërisht intriguese rreth kësaj deklarate të caktuar është se Ai po iu flet ndjekësve të vet më të afërt. Kjo nuk është nata e parë që ata kanë kaluar së bashku. Ai ka qenë “Rabini” i tyre. Ata kanë qenë me Jezusin vazhdimisht që nga ditët e para të shërbesës së Tij në tokë. Tema e dashurisë nuk erdhi si çudi – por ai u përqendrua specifikisht tek dashuria për njëri-tjetrin. Meqë ra fjala, pas ditës së Rrëshajëve dhe derdhjes së Frymës së Shenjtë, nuk kemi asnjë të dhënë të shkruar që apostujt luftuan mes tyre për pozitë dhe spikatje. Të gjithë janë të barabartë në rrëzë të kryqit. Fatmirësisht, Fryma e Shenjtë është duke punuar brenda secilit prej nesh për të lavdëruar vetëm Krishtin, dhe jo veten tonë apo ndonjë person tjetër.

Rezultati që nxjerrim nga kjo është se Kisha e Tij duhet të jetë e udhëhequr nga dashuria. Të duam mëkatarin, sigurisht. Kjo ishte ajo që mësoi Krishti. Fuqia e Frymës së Shenjtë u dha për të na aftësuar të jemi dëshmitarë më efikasë. Shembulli është në zemrën e dëshmisë së krishterë, dhe shembulli më i shndritshëm duhet të jetë midis besimtarëve. Një pjesë e mirë e “sensualitetit” që gjendej në kishat e ndryshme vendore të kohës së Dhjatës së Re rridhte nga marrëdhëniet e pahijshme midis besimtarëve – një mungesë e dukshme e **dashurisë agape** që shprehej kundrejt të krishterëve të tjerë. Thuhet që apostulli Gjon – i vetmi nga të Dymbëdhjetët që vdiq nga një vdekje natyrale – kur i kërkohej të lutej në vitet e tij të fundit të jetës, ai thjesht thoshte: “Fëmijë të vegjël, ta doni njëri-tjetrin”. Pjesa më e madhe e letrës së tij të parë i adresohet çështjeve që ndikojnë mbi marrëdhëniet e perëndishme në kishë. Ajo është një letër shumë personale, me një theks të madh tek miqësia me dashuri.

“Sepse ky është mesazhi, që dëgjuat nga fillimi. Që ta duam njëri-tjetrin... Ne e dimë se kemi kaluar nga vdekja në jetë, sepse i duam vëllezërit... Djema të mi, të mos duam me fjalë, as me gjuhë, por me vepra dhe me të vërtetë” (1 e Gjoni 3:11, 14, 18)

“Në këtë është dashuria: jo se ne e deshëm Perëndinë, por që ai na deshi ne dhe dërgoi Birin e tij si shlyerje për mëkatet tona. Të dashur, në qoftë se Perëndia na deshi kështu; kemi detyrë edhe ne të duam njëri-tjetrin ... Ne e duam atë, sepse ai na deshi i pari... Dhe këtë urdhërim kemi nga ai: ai që do Perëndinë, të dojë edhe vëllanë e tij.” (1 e Gjoni 4:10, 11, 19, 21, theksimi është i imi).

Le të shpresojmë që zhvillimi ynë frymëror të jetë i dukshëm, edhe për ne personalisht, edhe për të tjerët. Por, duhet të ngulmojmë. Lejojeni Fjalën e Perëndisë të jetë standardi i vetëm. Fryma e Shenjtë do të jetë projektori që ndriçon në vendet e thella dhe më sekrete të zemrës. Askush nga ne nuk do të arrijë ndonjëherë përsosmëri “absolute” në këtë jetë, por kjo periudhë “stazhi” këtu në tokë është që të na përgatisë për të përjetshmen. Lutja jonë e përditshme duhet të jetë: *Zot, le t’i sjellë jeta ime nder dhe lavdi Emrit Tënd të Shenjtë. Bëfsh të mundur që të tjerët të shohin atë që Ti po bën në jetën time dhe të dëshirojnë të jenë më shumë si Ty.*

Ky artikull është marrë nga libri KINGDOM LIVING © 2013 nga H. Maurice Lednicky. Përdorur me leje nga autori. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.



Dr. H. MAURICE LEDNICKY, ka qenë një shërbestar i shuguruar me Asamblëtë e Perëndisë për 50 vjet. Ai është autor, ungjilltar, pastor, misionar dhe ish-president i Kolegjit Biblik Qendror në Springfield, Missouri, SHBA

Jezusi Ecën mbi Ujë

Skicë Predikimi bazuar tek Mateu 14: 22-33

Hyrje:

Jezusi i dërgoi dishepujt në bregun tjetër matanë liqenit për një qëllim, edhe pse e dinte se ata do të hasnin në një stuhi të ashpër. Ai po iu mësonte atyre që t'i besonin qëllimit të tij, perceptimit të tij dhe fuqisë së tij.

Mesazhi:

1. Jezusi vepron me QËLLIM (vargjet 22-25)

- Ai vepron për t'iu treguar favorin e tij dhe për t'iu sjellë të mira ndjekësve të tij ...
 - për t'i bekuar me çdo bekim frymëror.
 - për t'i formuar sipas imazhit të tij.
 - për t'i bërë të përdorshëm në mbretërinë e tij.
- Besoni në besnikërinë e tij.
 - Çdo premtim që e ka bërë, ai ka për qëllim që ta përmbushë.

2. Jezusi sheh me PERCEPTIM (vargjet 26, 27)

- Ai dallon natyrën e vërtetë të ndjekësve të tij kur ata ...
 - përqendrohen tek stuhia në vend që të fokusohen tek besnikëria e tij.
 - e vënë në pikëpyetje atë që iu është thënë të bëjnë.
 - frikësohen nga rreziku dhe dështimi.
 - e vënë në dyshim praninë e tij për t'i ndihmuar që të dalin nga vështirësitë e tyre.
- Ai iu bën thirrje ndjekësve të tij që të besojnë në udhëheqjen e tij pa pasur frikë apo dyshim.

3. Jezusi vjen me FUQI (vargjet 28-33)

- Ai mund t'i ndryshojë gjërat tona negative dhe t'i kthejë ato në pozitive.
- Ai ka fuqinë që t'i bëjë të gjitha gjërat sipas vullnetit të tij.
 - Ai eci mbi ujë, dhe e aftësoi Pjetrin që të ecte mbi ujë.
 - Fuqia e tij është e pakufizuar dhe DASHURIA E TIJ ËSHTË E PAFUND.
- Besojini Jezusit duke e lënë kontrollin në duart e tij.

Përmbyllje:

Kur Jezusi ia tha këto fjalë Pjetrit tek vargu 31: "O njeri besimpak, pse dyshove?", ai nuk po fliste në mënyrë specifike për ecjen mbi ujë. Ai po e pyeste Pjetrin:

- Përse e vure në dyshim sigurinë e barkës? Unë të thashë të hyje në barkë. (v. 22)
- Përse dyshove kur erdhi stuhia? A nuk ju dërgova unë të prinit përpara në bregun tjetër? (v. 24)
- Përse dyshove kur më pe? A nuk më njeh ti mua? (v. 26)
- Përse dyshove për të ardhur tek unë? Ti më pyete, dhe unë të thashë: "Eja". (v. 29)

Besoni në qëllimin e tij. Kur Perëndia ju thotë të bëni diçka në mbretërinë e tij, ai ju jep një barrë dhe vendos dëshirën në zemrën tuaj. Jini të bindur dhe besojini Atij.

Ta dini se ai sheh me perceptim. MOS u habitni nëse hasni në ndonjë stuhi.

Besoni se ai ka fuqinë dhe autoritetin për të përmbushur gjithçka që ju ka thënë. Kur nuk ka më asgjë që mund të bëni, mund të luteni dhe të jeni të sigurt se atë që ai e filloi, ai edhe do ta mbarojë. (v. 32-34)

JIM DEARMAN është koordinator për botimin dhe shpërndarjen e librave për shtëpinë botuese "Life Publishers" në Springfield, Missouri. Më parë ai ka shërbyer si misionar në Afrikën Perëndimore për 22 vjet.

KOLEGJI TEOLOGJIK UNGJILLOR

...sepse Perëndia i të korrave vazhdon të thërrasë punëtorë!



Pastor, a keni nevojë që të zhvilloni bashkëpunëtorë frymërorë dhe të aftësuar në kishën tuaj? Lejoni që KTU të ndihmojë! KTU ekziston që...

- të përgatisë mbjellës kishash, pastorë, misionarë dhe shërbëtarë të tjerë me dijen e Fjalës së Perëndisë dhe me një shërbesë të efektshme në një kontekst pentakostal
- të mësojë teologji të shëndoshë dhe të zhvillojë udhëheqës shërbëtorë
- të avancojë ungjillin dhe të themelojë kisha pentakostale dhe të tjera ungjillore midis shqiptarëve dhe më gjerë në të tërë botën

Dhe është duke e përmbushur këtë qëllim.




Dëshmi nga ish-studentë...




Isha lutur për një kohë të gjatë për të shkuar në shkollë biblike sepse kisha nevojë për trainim dhe përgatitje. KTU ishte vërtet përgjigje e lutjeve të mia, pasi aty mora dijet dhe trainimin për të cilin kisha nevojë, si dhe rritjen dhe formimin frymëror të një shërbëtores. Si rrjedhojë përjetova Zotin në një mënyrë të re dhe këtu Ai më thirri dhe përgatiti për të shërbyer në Maqedoni, ku jam prej 6 vitesh duke vënë në praktikë gjithë trainimin frymëror të përfituar në KTU. Për të gjithë ata që kanë në zemër për t'i shërbyer Zotit dhe ndjejnë nevojën për një trainim më të thellë, KTU është vendi i duhur për rritjen dhe formimin tuaj frymëror. Zoti ju bekoftë.

RILINDA HOXHA, Kisha Uji i Jetës, Divjakë

Jam një pastor duke shërbyer në Bathore/Institut. Unë mund të them nga vetë eksperiencia ime që shkolla biblike është e domosdoshme për t'u përgatitur për një shërbesë efektive. KTU të pajis përmes Fjalës së Perëndisë dhe përvojave të bashkëbesimtarëve, me dashuri, njohuri dhe dituri. Unë jam dëshmitar i një procesi të bekuar rritjeje në KTU përgjatë tre viteve të studimit në këtë shkollë, ku shumë pastorë dhe shërbyes nga jashtë dhe brenda vendit, kanë ndarë me ne Fjalën por edhe përvojat e tyre, prej të cilave kam mësuar shumë. KTU është një familje e gjerë ku inkurajohesh dhe bekohesh. Sidomos për ty që ke një thirrje për t'i shërbyer Zotit, mund të jetë thelbësore për një shërbesë më efektive. Zoti ju drejtoftë me siguri.



GENCI ZEKA, Kisha Asambleja e Perëndisë, Bathore



Ne i jemi mirënjohës Perëndisë që na dha hir dhe mundësinë për t'i bërë studimet biblike në KTU së bashku për 3 vite. Megjithatë dëshirën e madhe për t'i shërbyer Atij, kishim nevojë që të rriteshim më shumë në ZOTIN, por edhe në marrëdhënien me njëri tjetrin si çift. Ishte e vështirë për ne sepse familjet tona nuk e kuptonin thirrjen tonë për shërbesë apo të ofronin mbështetje financiare. Por ne u lutëm me besim dhe Perëndia siguroi gjithçka që patëm nevojë. Tani jemi duke shërbyer në kishëmbjellje dhe gëzohemi që Perëndia po përdor jetët tona. Është bukur kur shohim fryte në jetët tona, si dhe njerëz që marrin shpëtimin me anë të besimit tek shpëtimtari ynë Jezus Krisht. Shkolla Biblike është shumë e rëndësishme nëse doni të rriteni në Frymë dhe të përjetoni madhështinë e Zotit. Nëse dëshiron të dëgjosh thirrjen e Zotit në jetën tënde dhe ta ndjekësh atë, duhet të investosh në rritjen tënde përmes KTU-së sepse Perëndia ka një plan për ty.

PARID dhe MARINELA NUHI, Kisha Asambleja e Perëndisë, Durrës

Për më shumë informacion, kontaktoni zyrën e administratës së KTU:

ktu@icc-al.org ♦ Cel.: 069-40-68956